



EUROPEAN CENTRE
FOR MINORITY
ISSUES KOSOVO

Komunitetet: Dini të drejtat tuaja

Broshurë për komunitetet dhe pjesëtarët e tyre

Duke punuar për një
Kosovë stabile shumë-etnike

Mbështetur nga



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Federal Department of Foreign Affairs FDFA



Falënderime

ECMI Kosova dëshiron të falënderojë Departamentin Federal Zviceran të Punëve të Jashtme (DFPJ) për mbështetjen e tyre në hartimin e këtij publikimi, në kuadër të projektit 'Mbështetje për Qeverisjen Efektive për Komunitetet Minoritare në Kosovë'.

ECMI Kosova www.ecmikosovo.org

ECMI Kosova është organizata kryesore joqeveritare e angazhuar me çështje të komuniteteve minoritare në Kosovë, me qëllim të zhvillimit të institucioneve përfshirëse, përfaqësuese dhe të ndjeshme ndaj komuniteteve, institucione këto që mbështesin një Kosovë të qëndrueshme shumë-etnike.

ECMI Kosova kontribuon në zhvillimin, forcimin dhe zbatimin e legjislacionit përkatës, dhe përkrah institucionalizimin e mekanizmave qeveritarë të ndërlidhur me çështje të komuniteteve, dhe ngrit kapacitetet e akterëve të shoqërisë civile dhe të qeverisë për t'u angazhuar me njëri-tjetrin dhe bashkëpunuar në mënyrë konstruktive dhe të qëndrueshme.

Rr. Nëna Terezë nr. 41, Apt. 29
10000 Prishtinë, Kosovë
Tel. +381 (0) 38 224 473

Rr. Čika Jovina Nr. 3, 1st Fl
38220 Mitrovicë Veriore, Kosovë
Tel. +381 (0) 64 00 55 488

Vërejtje

Ky publikim është hartuar me mbështetjen financiare të Departamentit Federal Zviceran të Punëve të Jashtme (DFPJ). Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e ECMI Kosovës dhe nuk mund të merret në asnjë mënyrë se pasqyron pikëpamjet e DFPJ-së së Zvicrës.

E drejta e autorit

© Qendra Evropiane për Çështje të Minoriteteve (ECMI) në Kosovë. Tetor 2013. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në sisteme ripërtëritëse ose të transmetohet në çfarëdo forme apo me çfarëdo mjeti, elektronik, mekanik, foto-kopjimi, regjistrimi, apo çfarëdo mjeti/formë tjetër, pa lejen paraprake të ECMI Kosovës.

PËRMBAJTJA

I.	HYRJE	6
II.	CILAT JANË TË DREJTAT TUAJA?	7
2.1.	Çfarë janë ‘komunitetet’ në Kosovë dhe cilët janë pjesëtarët e tyre?	7
2.2.	Mos-diskriminimi: Në çfarë bazash?	8
2.3.	Siguria dhe liria e lëvizjes	9
2.4.	Të drejtat e ndërlidhura me identitetin	10
2.5.	Kultura dhe religjioni	10
	<i>Kultura</i>	10
	<i>Religjioni</i>	11
2.6.	Gjuha	14
	<i>Përdorimi i gjuhëve në nivel shtetëror</i>	14
	<i>Përdorimi i gjuhëve në nivel komunal</i>	16
	<i>Përdorimi i gjuhëve në sistemin e drejtësisë</i>	18
	<i>Emrat personale</i>	19
	<i>Përdorimi i gjuhëve në sferën private</i>	19
2.7.	Mediat	20
	<i>Të përgjithshme</i>	20
	<i>Transmetuesi publik</i>	20
2.8.	Arsimi	22
	<i>Plan-programi</i>	22
	<i>Gjuha e mësimdhënies</i>	23
2.9.	Mundësitë ekonomike dhe sociale	26
	<i>Të përgjithshme</i>	26
	<i>Punësimi</i>	27
2.10.	Shëndetësia	29
	<i>Të përgjithshme</i>	29
	<i>Kompetencat e shtuara komunale</i>	30

2.11. Pjesëmarrja politike	30
<i>Partitë politike</i>	<i>31</i>
<i>Niveli qendror</i>	<i>31</i>
<i>Niveli komunal.....</i>	<i>37</i>
III. ÇFARË TË BËNI NËSE TË DREJTAT TUAJA JANË SHKELUR	41
2.12. Avokati i Popullit	41
2.13. Ankesat kundër një vendimi komunal	43
<i>Mekanizmat e drejtpërdrejtë.....</i>	<i>43</i>
<i>Mekanizmat indirektë.....</i>	<i>44</i>
<i>Zëvendës-Kryesuesi i Kuvendit Komunal për Komunitete.....</i>	<i>44</i>
2.14. Mekanizmat për çështje të veçanta.....	45
<i>Zyra e Komisionerit për Gjuhët</i>	<i>45</i>
<i>Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (KPMK)</i>	<i>47</i>
<i>Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM)</i>	<i>48</i>
IV. KORNIZA LEGJISLATIVE	49

LISTA E AKRONIMEVE DHE SHKURTESAVE

DPMB	Deklarata e Politikave për Mundësi të Barabarta
ECMI Kosova	Qendra Evropiane për Cështje të Minoriteteve në Kosovë
KDIKK	Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KIM	Këshili për Implementim dhe Monitorim
KKK	Këshilli Konsultativ për Komunitete
KPK	Këshilli Prokurorial i Kosovës
KPM	Komisioni i Pavarur i Mediave
KPMK	Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Kosovës
MAShT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknoogjisë
ND	Ndërmarrje Publike
NjKDNj	Njësia Komunale për të Drejtat e Njeriut
OJQ	Organizata të Shoqërisë Civile
OPK	Organizatat Përfaqësuese të Komuniteteve
RTK	Radio-Televizioni i Kosovës
UNMIK	Misioni i Përkohshëm i Administratës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë
ZKGj	Zyra e Komisionerit për Gjuhët
ZKKK	Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim
ZvKKK	Zëvendës-Kryetari i Komunës për Komunitete
ZvKKKK	Zëvendës-Kryesuesi i Kuvendit Komunal për Komunitete
ZVM	Zonat e Veçanta të Mbrojtura

I. HYRJE

Të gjithë individët në Republikën e Kosovës kanë të drejtë të barabartë për të gëzuar mbrojtje të të drejtave fundamentale njerëzore të tyre. Për shembull, mbrojtja e tillë ndërthet mbrojtjen e përgjithshme kundër diskriminimit, të drejtën në jetë, lirinë e të shprehurit dhe mbledhjes, dhe shumë të drejta tjera.

Megjithatë, pjesëtarët e komuniteteve pakicë në Kosovë mund të mos jenë në gjendje të gëzojnë këto të drejta tejet fundamentale në të njëjtën mënyrë sikur edhe pjesëtarët e popullatës shumicë. Për shembull, edhe pse liria e të shprehurit është e drejtë universale, ajo bëhet e pakuptimtë nëse pjesëtarëve të komuniteteve të shprehurit u lejohej vetëm në gjuhët që ata nuk i kuptojnë. Për këtë arsye, komunitetet kërkojnë të drejta shtesë në mënyrë që të 'mund të gëzojnë kushte të barabarta'. Kjo shtresë e dytë e mbrojtjes së komuniteteve siguron që pjesëtarët e komuniteteve realizimin e këtyre të drejtave fundamentale.

Të drejtat e komuniteteve në Kosovë garantohej nga një varg aktesh legislative primare dhe sekondare, përfshirë Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe ligjin bazik mbi Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Kosovë (03/L-047)¹, akte këto që mbulojnë të drejtat e komuniteteve nga një prizëm i gjerë. Përveç këtyre, janë miratuar ligje të veçanta që mbulojnë fusha të caktuara në mënyrë më të hollësishme, përfshirë Ligjin mbi Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës (03/L-068), Ligjin për Arsimim Parauniversitar në Republikën e Kosovës (2011/04-L-032), Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve (02/L37), Ligjin për Vetëqeverisje Lokale (03/L-040), dhe Ligjin për Zonat e Veçanta të Mbrojtura (03/L-039). Për një listë gjithëpërfshirëse të ligjeve më të rëndësishme të Kosovës që prekin të drejtat e komuniteteve, lutemi të konsultoni kapitullin 4.

Kjo broshurë ka për qëllim që komuniteteve dhe pjesëtarëve të komuniteteve t'ua sigurojë një pasqyrë të thuktë të të drejtave të tyre. Në kaptinën e parë listohen të drejtat që bazohen në çështje të ndryshme, duke i theksuar dispozitat më të rëndësishme të ndërlidhura me to. Kaptina e dytë sqaron çfarë duhet bërë në rast të shkeljes së këtyre të drejtave dhe jep udhëzime të detajuara mbi parashtrimin e ankesave formale para institucioneve të ndryshme.

¹ Në tekstin e mëtejshëm – Ligji për Komunitetet.

II. CILAT JANË TË DREJTAT TUAJA?

2.1. Çfarë janë ‘komunitetet’ në Kosovë dhe cilët janë pjesëtarët e tyre?

Në Kosovë termi ‘komunitet’ përdoret në dy nivele. Në radhë të parë, ai nënkupton grupet e individëve që kanë karakteristika të përbashkëta, siç janë për shembull etnia, gjuha apo religjioni. Në këtë kuptim, ky term mund të përdoret për t’iu referuar të gjitha grupeve në Kosovë, pa marrë parasysh a përbëjnë shumicë apo pakicë.

Megjithatë, nga aspekti ligjor, ky term i referohet grupeve minoritare të Kosovës.² Ligjet e Kosovës, ‘komunitetet’ përkufizohen si “grupe kombëtare, etnike, kulturore, gjuhësore apo fetare të cilat tradicionalisht janë të pranishme në Kosovë, e të cilat nuk përbëjnë shumicën”.³ Konkretisht, këto grupe përfshijnë:

- Serbët
- Turqit
- Boshnjakët
- Romët
- Ashkalijtë
- Egjiptasit
- Goranët
- Kroatët
- Malazezët.

Megjithatë, kjo listë nuk është e përmbyllur dhe “komunitetet tjera” gjithashtu mund të përfitojnë nga këto të drejta.

Është me rëndësi që të theksohet se pjesëtarët e komunitetit shumicë (shqiptarët) që përbëjnë pakicën e popullatës së një komune të caktuar sipas definicionit gjithashtu konsiderohen “komunitete” dhe rrjedhimisht gëzojnë të drejtat e komuniteteve.

² Raporti i Qendrës Evropiane për Çështje të Minoriteteve (ECMI) në Kosovë “Fuqizimi i Kornizës Institucionale për Komunitetet në Kosovën e Pavarur”, janar 2009, faqe 11.

³ Ligji për përlloqsim-ndryshimin e Ligjit nr. 03/L-047 për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre, neni 1. , neni

Vëreni se të drejtat e komuniteteve nuk mund të ushtrohen nëse shkelen ligjet e Kosovës apo standardet ligjore ndërkombëtare.

2.2. Mos-diskriminimi: Në çfarë bazash?

Të gjithëve njerëzve në Kosovë ju garantohet mbrojtje Shtetërore nga diskriminimi. Në rastet kur diskriminimi i tillë i pengon pjesëtarët e komuniteteve në ushtrimin e këtyre të drejtave fundamentale, Shteti duhet të marrë masa speciale për të parandaluar këtë.

Bazat për ndalimin e diskriminimit

Diskriminimi ndalohet në baza të ndryshme. Posaçërisht relevante për komunitetet janë bazat e identitetit kombëtar, etnik, kulturor, gjuhësor apo religjioz.⁴

Diskriminimi i drejtpërdrejtë dhe i tërthortë

Diskriminimi përfshin edhe diskriminimin ‘e drejtpërdrejtë’ edhe ‘të tërthortë’.

- Diskriminimi ‘i drejtpërdrejtë’ ndodh kur një person trajtohet në mënyrë më të pafavorshme se një person tjetër në situatë të ngjashme.
- Diskriminimi ‘i tërthortë’ ndodh kur një dispozitë apo praktikë që në dukje është neutrale, në fakt vë në pozitë të pafavorshme një grup të caktuar njerëzish, për shkak të identitetit të tyre kombëtar, etnik, kulturor, gjuhësor ose fetar.⁵

⁴ Kushtetuta, neni 24.2; Ligji për Komunitetet (03/L-047), neni 3.3. Duhet theksuar se ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit që parashtrohet me Ligjin Kundër Diskriminimit (2004/3), të vitit 2004, liston edhe baza tjera, siç është gjinia (neni 2.a).

⁵ Ligji për Komunitetet (03/L-047), neni 3.3; Ligji kundër diskriminimit (2004/3), neni 2.a, 3.a, 3.b.

Shembui të diskriminimit të drejtpërdrejtë:

- Një punëdhënës refuzon të punësojë gra në pozita menaxhuese. Kjo përbën diskriminim të drejtpërdrejtë më bazë në gjini.
- Një dyqan u refuzon hyrjen njerëzve të një etnie të caktuar. Kjo përbën diskriminim të drejtpërdrejtë bazuar në përkatësinë etnike.

Shembull i diskriminimit të tërthortë:

- Një kompani pastrimi u kërkon personelit të saj për pastrim që të kenë diploma të shkollës së mesme dhe dhjetë vjet përvojë pune. Një punë e thjeshtë pastrimi nuk kërkon as diplomë të shkollës së mesme e as dhjetë vjet përvojë pune. Prandaj kjo mund të përbëjë diskriminim të tërthortë kundër personave të rinj (të cilët ende nuk mund të kenë dhjetë vjet përvojë pune), si dhe ndaj komuniteteve të cilët mesatarisht kanë më pak gjasa që të përfundojnë shkollën e mesme.

Nëse ju bini pre e akteve të diskriminimit apo kërcënimit – përfshirë frikësimin, veprimet armiqësore apo dhunën – si rezultat i faktit që bëni pjesë apo jeni i ndërlidhur me një komunitet të caktuar, Shteti është i obliguar që të ndërmarrë të gjitha masat e domosdoshme për të ju mbrojtur.⁶ Ngjashëm, nëse nuk mund të ushtroni të drejtat tuaja themelore për të njëjtat arsye, Shteti duhet të ndërmarrë ‘masa të posaçme’ për të korrigjuar këtë.

Vini re se këto masa në vete nuk konsiderohen diskriminuuese, por duhet të aplikohen deri sa të jetë arritur qëllimi i tyre.⁷

2.3. Siguria dhe liria e lëvizjes

Si pjesëtar i komunitetit, juve ju garantohen edhe liria e lëvizjes edhe siguria e mbrojtja në tërë Kosovën. Shteti është i obliguar që këto të drejta t’i mbrojtë në emër tuaj.⁸ Këto të drejta aplikohen krahas të drejtave tuaja si qytetar apo banor legjitim të Kosovës për të zgjedhur vetë vendbanimin tuaj.⁹

⁶ Kushtetuta, neni 48.3; Ligji për Komunitetet (03/L-047), neni 3.2.

⁷ Ligji për Komunitetet (03/L-047), neni 3.3, 1.2.

⁸ Ligji për Komunitetet (03/L-047), neni 3.5.

⁹ Kushtetuta, nenet 29.1, 35.

2.4. Të drejtat e ndërlidhura me identitetin

Kjo kaptinë përqendrohet në çështje më të gjera që kanë të bëjnë me identitetin, siç janë e drejta për t'u asocuar me një komunitet të caktuar, dhe ndalimi i asimilimit të detyruar.

E drejta e asocimit vullnetar

Nëse i përkisni një komuniteti, jeni të lirë të zgjedhni nëse doni të trajtoheni si pjesëtar i atij komuniteti, apo nëse nuk doni t'i ushtroni të drejtat që i përkasin komunitetit tuaj. Çfarëdo vendosje në situatë të pafavorshme, apo diskriminimi me të cilin mund të përballeni si rezultat i zgjedhjes së bërë, përbën vepër joligjore.¹⁰

Ndalimi i asimilimit të dhunshëm

Nëse jeni pjesëtar i një komuniteti, ju nuk mund t'i nënshtroheni politikave apo praktikave të cilat mëtojnë t'ju asimilojnë kundër dëshirës suaj.¹¹ Nëse kjo ndodh, ju keni të drejtë të gëzoni mbrojtje nga Shteti.

2.5. Kultura dhe religjioni

Të drejtat e komuniteteve në Kosovë në masë të gjerë theksojnë të drejtën për të mbrojtur dhe promovuar kulturën e komunitetit dhe sigurinë e lirisë fetare, dhe për të mbrojtur trashëgiminë e tyre fetare dhe kulturore. Në këtë kontekst, komuniteti serb përfiton nga një tërësi e veçantë të drejtash. Këto të drejta janë përvijuar më hollësisht më poshtë.

Kultura

Nëse jeni pjesëtar i një komuniteti në Kosovë, ju keni të drejta kushtetuese për ta shprehur, mbajtur dhe zhvilluar më tej kulturën dhe traditat tuaja. Ju gjithashtu keni të drejtë të administroni zhvillimet tuaja kulturore.¹² Shteti ka për obligim t'ju krijojë kushte juve dhe komunitetit tuaj për të realizuar këtë.¹³

Si komunitet, ju keni të drejtë të themeloni organizata përfaqësuese të komunitetit (OPK). Ato inkurajohen t'ju ndihmojnë në menaxhimin e resurseve që ju vihen në dispozicion për të avancuar jetën kulturore të komunitetit.¹⁴ Kjo duhet të bëhet në përputhje me kodin e mirësjelljes sa i

¹⁰ Ligji për Komunitetet (03/L-047), neni 1.5.

¹¹ Ligji për Komunitetet (03/L-047), neni 2.3.

¹² Kushtetuta, neni 59.1; Ligji për Komunitetet, neni 5.1.

¹³ Ligji për Komunitetet, neni 2.2.

¹⁴ Ligji për Komunitetet, neni 11.5.

përket përfaqësimit demokratik, funksionimit, efikasitetit dhe transparencës financiare, i cili duhet të miratohet nga organizata juaj përfaqësuese përmes Këshillit Konsultativ për Komunitete (KKK).¹⁵ Për më shumë informata mbi KKK-së, shihni pjesën 2.11.

Ju dhe komuniteti juaj gjithashtu keni të drejtë të themeloni shoqata qytetare kulturore, artistike, shkencore dhe edukative dhe shoqata tjera.¹⁶

Vini re se organizatat dhe shoqatat e komuniteteve kanë të drejtë për mbështetje dhe ndihmë financiare, përfshirë edhe atë nga Qeveria.¹⁷

Simbolet

Komuniteti juaj ka të drejtë të përdor dhe t'i vë në dukje simbolet e veta.¹⁸

Kontakti i lirë

Si pjesëtar i një komuniteti, ju dhe OPK-të keni të drejtë të mbani kontaktet me persona tjerë – qoftë në Kosovë apo në ndonjë Shtet tjetër – me të cilët keni identitet të përbashkët etnik, kulturor, fetar apo gjuhësor, apo trashëgimi kulturore të përbashkët.¹⁹

Religjioni

Republika e Kosovës është Shtet sekular, nuk ka religjion zyrtar dhe është neutral sa i përket çështjeve të besimit fetar.²⁰

Sikur edhe të gjithë banorët e Kosovës, ju keni të drejtë në lirinë e besimit, ndërgjegjes dhe fesë, të cilat iu garantohen të gjithë personave në Kosovë.²¹ Kjo e drejtë përfshinë lirinë për të pasur, mos pasur, mbajtur apo ndryshuar fenë apo besimin. Gjithashtu, kjo përfshinë të drejtën e manifestimit të fesë apo besimit (adhurimin, mësimdhënien, praktikumin apo vëzhgimin), qoftë i vetëm qoftë në komunitet me të tjerët, qoftë publikisht qoftë privatisht.²²

¹⁵ Law on Communities (03/L-047), Article 5.3.

¹⁶ Ligji për Komunitetet (03/L-047), neni 5.2.

¹⁷ Ligji për Komunitetet (03/L-047), neni 5.4.

¹⁸ Kushtetuta, neni 59.7; Ligji për Komunitetet (03/L-047), neni 5.6.

¹⁹ Ligji për Komunitetet (03/L-047), neni 5.7.

²⁰ Kushtetuta, neni 8; Ligji për Komunitetet, neni 7.1.

²¹ Kushtetuta, neni 38.1 ; Ligji për Komunitetet, neni 7.2.

²² Ligji për Komunitetet (03/L-047), neni 7.2.

Si ju ashtu edhe komuniteti juaj keni të drejtën e lirisë së religjionit. Shtetit nuk i ndalohe shprehimisht interferimi me këtë të drejtë²³, por ai obligohet të mbrojë praktikimin e riteve fetare, formave tradicionale të jetës fetare, përfshirë jetën në monastire dhe arsimimin fetar, si dhe pronën kishtare.²⁴

Ju dhe komuniteti juaj gjithashtu keni të drejtë të themeloni organizata dhe institucione fetare të komunitetit tuaj.²⁵

Kufizimet ndaj lirisë së religjionit:

E drejta për lirinë e religjionit – sikur të gjitha të drejtat e njeriut – nuk është absolute; Shteti mund të vendosë kufizime ndaj të drejtës së lirisë së fesë, por vetëm kur ka interes bindës për ta bërë këtë, më së shumti në rastet kur ushtrimi i kësaj të drejte çon në shkelje serioze të të drejtave të tjera themelore.

Festat tradicionale dhe fetare

Ju dhe komuniteti juaj keni të drejtë të festoni festat tuaja tradicionale dhe fetare në mënyrë të lirë dhe të hapur, në pajtim me ligjin.²⁶

Trashëgimia fetare dhe kulturore

Të përgjithshme

Republika e Kosovës ka obligim ligjor të mbrojë trashëgiminë kulturore dhe fetare të të gjitha komuniteteve. Nëse komuniteti juaj beson se lokacione apo monumente të caktuara kanë rëndësi kulturore dhe fetare, Shteti është i obliguar t'i mbrojë ato.

Qeveria mund t'ia delegojë detyrën e përkujdesjes për këto lokacione OPK-së suaj, me kusht që ajo organizatë ka vullnet dhe mundësi për të kryer atë. Për kryerjen e këtij obligimi mund të ofrohen edhe mjete financimi.²⁷

Kompetencat e shtuara komunale

Të gjitha Komunitet me shumicë serbe²⁸ mund të ushtrojnë përgjegjësinë në çështjet kulturore, përfshirë mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë

²³ Ligji për Komunitetet (03/L-047), neni 7.3.

²⁴ Ligji për Komunitetet (03/L-047), neni 7.4.

²⁵ Ligji për Komunitetet (03/L-047), neni 7.7.

²⁶ Ligji për Komunitetet (03/L-047), neni 5.5.

²⁷ Ligji për Komunitetet (03/L-047), neni 5.12.

kulturore e fetare serbe brenda territorit të komunës, si dhe përkrahjen komuniteteve fetare lokale.²⁹

Kisha Ortodokse Serbe

Nëse jeni pjesëtar i komunitetit serb në Kosovë, ju dhe komuniteti juaj gëzoni të drejta shtesë sa i përket mbrojtjes së monumenteve tuaja fetare, historike dhe kulturore, veçanërisht të Monastireve ortodokse serbe.³⁰

“Zonat e Veçanta të Mbrojtjes” (ZVM) janë krijuar përreth monumenteve, grupeve të ndërtesave, fshatrave apo qendrave historike të cilat janë me rëndësi të veçantë për komunitetin serb. Nëse një zonë është përcaktuar të jetë ZVM, ajo duhet të mbrohet nga zhvillimet në të dhe nga veprimtaritë të cilat mund ta dëmtojnë kontekstin historik, kulturor, arkitektonik apo arkeologjik të saj, apo mjedisin natyror a estetik të saj.³¹

Ky proces monitorohet dhe udhëhiqet nga një Këshill për Implementim dhe Monitorim (KIM). Në rast të kontestit mes Kishës Ortodokse Serbe dhe autoriteteve qendrore apo lokale të Kosovës, KIM mund të ndërmjetësojë mes dy palëve.³²

Qendra historike e komunës së Prizrenit, e cila përfshin trashëgiminë kulturore të bashkësive të ndryshme, ka një status të veçantë në Kosovë dhe është njohur si pronë e trashëgimisë historike dhe kulturore nën mbrojtje të përhershme.³³ Si e tillë, ajo u nënshtrohet një sërë masash mbrojtëse, përfshirë atyre në lidhje me aktivitetet e ndërtimit. ‘Këshilli për Trashëgimi Kulturore të Qendrës Historike të Prizrenit’ është përgjegjës për mbikëqyrje dhe dhënien e këshillave mbi aktivitetet që lidhen me ruajtjen e trashëgimisë kulturore të mbrojtur. Ky këshill përbëhet nga shtatë anëtarë, përfshirë nga përfaqësues (për secilën nga një) i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim (ZKKK), si dhe nga një përfaqësues i Kishës Ortodokse Serbe, Kishës Katolike dhe Bashkësisë Islame.³⁴

²⁸ Nga tetori 2013, Kosova ka 10 komuna me shumicë serbe: Leposaviqi; Zveçani; Mitrovica e Veriut; Zubin Potoku; Graçanica; Ranillugu; Parteshi; Novobërda; Shtërpca; Klokoti.

²⁹ Ligji për Vetëqeverisje Lokale (03/L-040), neni 22.1.

³⁰ Ligji për Komunitetet (03/L-047), neni 7.6; Ligji për Krijimin e Zonave të Veçanta të Mbrojtjes, neni 1.

³¹ Ligji për Krijimin e Zonave të Veçanta të Mbrojtjes, neni 2.

³² Ligji për Krijimin e Zonave të Veçanta të Mbrojtjes, neni 4.

³³ Ligji për Zonën Historike të Prizrenit (2011/04-L-066), neni 1.

³⁴ Ligji për Zonën Historike të Prizrenit (2011/04-L-066), neni 14.

2.6. Gjuha

Çështja e gjuhës është absolutisht kyçe për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve në Kosovë, pasi që ajo ka ndikim në shumë fusha tjera të rëndësishë së veçantë për komunitetet, siç janë arsimi, pjesëmarrja politike, mediat, dhe qaja e barabartë, mes tjerash, në mundësi punësimi.

Kjo kaptinë do të shtjellojë dispozitat që kanë të bëjnë me përdorimin e gjuhëve në sferën publike, si në nivel qendror ashtu edhe në atë lokal; në shërbime publike; në sistemin e drejtësisë; dhe në sferën private. Çështja e gjuhëve në kontekst të arsimit dhe mediave dhe të trajtohet ndaras në më poshtë.

Përdorimi i gjuhëve në nivel shtetëror

Gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës

Gjuhë zyrtare në Republikën e Kosovës janë gjuha shqipe dhe serbe, dhe alfabetet përkatëse të tyre.

Çdo person në Kosovë ka të drejtë të komunikojë me institucionet qendrore dhe të pranojë shërbimet apo dokumentet publike në cilëndo gjuhë zyrtare. Të gjitha institucionet qendrore duhet siguruar dhe mundësuar këtë.³⁵

Takimet dhe puna e institucioneve qendrore

Tek institucionet qendrore, gjuhët zyrtare të Kosovës gëzojnë status të barabartë.³⁶

Të gjitha ligjet e Kuvendit të Kosovës duhet të miratohen dhe publikohen në gjuhët zyrtare. Të dyja versionet gëzojnë autoritet të barabartë.³⁷ “Ligjet e shpallura” (ligjet që janë shpallur formalisht nëpërmjet dekretit të Presidentit të Kosovës) duhet të publikohen edhe në gjuhën boshnjake dhe atë turke.³⁸

Shënimet dhe dokumentet zyrtare duhet të mbahen dhe lëshohen në gjuhë zyrtare.³⁹

³⁵ Ligji për Përdorimin e Gjuhëve (02/L-37), neni 4.2.

³⁶ Ligji për Komunitetet (03/L-047), neni 4.1.

³⁷ Ligji për Përdorimin e Gjuhëve (02/L-37) (03/L-047), neni 5.4.

³⁸ Ligji për Përdorimin e Gjuhëve (02/L-37) (03/L-047), neni 5.4.

³⁹ Ligji për Përdorimin e Gjuhëve (02/L-37) (03/L-047), neni 4.5.

Nëse jeni zyrtar apo punonjës i cilitdo institucion qendror, ju keni të drejtë të përdorni në punën tuaj cilëndo nga gjuhët zyrtare (d.m.th. shqipen ose serbishten). Kjo e drejtë duhet të mundësohet nga institucioni përkatës, posaçërisht gjatë debateve, procedurave dhe takimeve, si dhe në të gjitha takimet publike që organizohen nga to.⁴⁰ Nëse ju kërkoni, institucioni duhet të ofrojë përkthim në të gjitha takimet nga njëra gjuhë zyrtare në tjetrën.⁴¹

Nëse gjuha juaj zyrtare *nuk* është një nga gjuhët zyrtare në Kosovë, ekzistojnë dispozita speciale të cilat janë të zbatueshme për ju në kontekst të institucioneve qendrore:

- *Qeveria*. Nëse jeni anëtar i Qeverisë dhe gjuha juaj amtare nuk është një nga gjuhët zyrtare, ju keni të drejtë që gjuhën tuaj ta përdorni në të gjitha takimet e institucioneve qendrore, si dhe në të gjitha takimet publike të organizuara nga to. Sipas kërkesës suaj, institucionet qendrore duhet të sigurojnë përkthim.⁴²
- *Kuvendi i Kosovës*. Nëse jeni deputet i Kuvendit dhe gjuha juaj amtare nuk është një nga gjuhët zyrtare, ju keni të drejtë të përdorni gjuhën tuaj amtare gjatë punës, debateve dhe procedurave tjera të Kuvendit, dhe Komisioneve përkatëse, si dhe në të gjitha takimet publike të organizuara nga ai. Sipas kërkesës suaj, duhet t'ju sigurohet përkthim në gjuhën tuaj amtare. Të gjitha dokumentet që ju i dorëzoni në gjuhën tuaj amtare duhet të përkthehen në gjuhë zyrtare dhe të gjitha përgjigjet që ju i pranoni duhet të jenë në gjuhën tuaj amtare.⁴³
- *Avokati i Popullit*. Nëse gjuha juaj amtare nuk është një nga gjuhët zyrtare të Kosovës dhe ju doni të parashtroni ankesë në zyrat e Avokatit të Popullit, ju keni të drejtë të paraqitni

⁴⁰ Ligji për Përdorimin e Gjuhëve (02/L-37) (03/L-047), neni 4.7.

⁴¹ Ligji për Përdorimin e Gjuhëve (02/L-37) (03/L-047), Nenet 4.3, 5.1.

⁴² Ligji për Përdorimin e Gjuhëve (02/L-37) (03/L-047), neni 4.4.

⁴³ Ligji për Përdorimin e Gjuhëve (02/L-37) (03/L-047), neni 5.2.

ankesat tuaja verbale apo shkresat tuaja në gjuhën tuaj amtare. Ju gjithashtu keni të drejtë të pranoni përgjigjen në gjuhën tuaj amtare.⁴⁴ Për më tepër hollësi në lidhje me dorëzimin e ankesave Avokatit të Popullit, shihni pjesën 2.12 më poshtë.

Përdorimi i gjuhëve në nivel komunal

Siç u theksua më lartë, gjuha shqipe dhe serbe gëzojnë status zyrtar në tërë Kosovën dhe në të gjitha nivelet e Qeverisë. Megjithatë, edhe gjuhët e komuniteteve tjera mund të fitojnë statusin e gjuhëve zyrtare në nivel komunal, në rast se plotësohen disa parakushte demografike.

Gjuhët me status zyrtar në nivel komunal

Nëse jeni pjesëtar i një komuniteti gjuha e të cilit nuk është gjuhë zyrtare, ndërsa që komuniteti juaj përbën së paku 5% të popullatës komunale, gjuha juaj mund të shpallet gjuhë zyrtare në nivel komunal.

Turqishtja në Prizren:

Ligji për Përdorimin e Gjuhëve (neni 2.3) i jep gjuhës turke statusin e gjuhës zyrtare në komunën e Prizrenit, pavarësisht nga faktorët demografikë. Ky nen njih rëndësinë historike të gjuhës turke në Prizren.

Në kuadër të institucioneve komunale, gjuhët zyrtare të komunës gëzojnë status të barabartë.⁴⁵ Vini re se me ‘gjuhët zyrtare’ këtu i referohemi gjuhës shqipe dhe asaj serbe, dhe cilëso gjuhe tjetër të komuniteteve që është avancuar në status të gjuhës zyrtare në nivelin komunal.

Nëse gjuha e komunitetit tuaj gëzon statusin e gjuhës zyrtare në nivelin komunal, ju keni të drejtë të komunikoni me institucionet dhe zyrtarët komunalë në atë gjuhë. Kjo përfshin të drejtën për të marrë shërbimet në dispozicion dhe dokumentet publike në atë gjuhë. Secili organ përfaqësues dhe ekzekutiv komunal ka për detyrë të sigurojnë që kjo të jetë e mundur.⁴⁶

Të gjitha gjuhëve zyrtare të komunës u është akorduar status i barabartë në mbledhjet dhe punën e institucioneve komunale. Sipas kërkesës tuaj, institucionet komunale duhet të vënë në dispozicion përkthim në të folur nga

⁴⁴ Ligji për Përdorimin e Gjuhëve (02/L-37) (03/L-047), neni 6.

⁴⁵ Ligji për Përdorimin e Gjuhëve (02/L-37) (03/L-047), neni 7.1.

⁴⁶ Ligji për Përdorimin e Gjuhëve (02/L-37) (03/L-047), neni 7.2.

një gjuhë zyrtare në tjetrën, në mbledhjet brenda Komunës si dhe në mbledhjet publike të organizuara nga Komuna.⁴⁷

Rregulloret dhe aktet nënligjore duhet të shtypen dhe publikohen në gjuhët zyrtare të komunës. Të gjitha versionet janë të barasvlershme.⁴⁸

Dokumentet zyrtare duhet të ruhen dhe të bëhen publike në të gjitha gjuhët zyrtare të komunës. Këto përfshijnë shënimet dhe të dhënat nga mbledhjet, shënimet dhe të dhënat zyrtare të organeve përfaqësuese dhe ekzekutive komunale, regjistrat publikë, e kështu me radhë.

Emrat zyrtarë të institucioneve dhe organeve komunale duhet të shfaqen në gjuhët zyrtare të Komunës, ashtu si edhe shenjat zyrtare që tregojnë emrat e komunave , fshatrave, rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike.⁴⁹

Gjuhët në përdorim zyrtar në nivel komunal

Nëse jeni pjesëtar i një komuniteti gjuha e të cilit nuk është gjuhë zyrtare, ndërsa që komuniteti juaj përbën mes 3% dhe 5% të popullatës në komunë, gjuha juaj mund të bëhet gjuhë “në përdorim zyrtar” në nivel komunal.

Përveç kësaj, nëse gjuha e komunitetit tuaj është folur tradicionalisht në komunën e caktuar, ajo do të konsiderohet gjuhë në përdorim zyrtar në po këtë komunë.⁵⁰

Nëse gjuha e komunitetit tuaj është gjuhë në përdorim zyrtar në nivelin komunal, ju keni të drejtë t’u drejtoheni ose t’u parashtroni kërkesa me shkrim institucioneve dhe zyrtarëve komunalë në po atë gjuhë. Pas kërkesës suaj, institucionet duhet të përgjigjen në po atë gjuhë.⁵¹ Ngjashëm, sipas kërkesës suaj, organi ekzekutiv dhe/ose përfaqësuesi komunal në fjalë duhet të sigurojë që rregulloret dhe aktet nënligjore komunale të nxirren dhe publikohen në atë gjuhë.⁵²

⁴⁷ Ligji për Përdorimin e Gjuhëve (02/L-37) (03/L-047), neni 7.3.

⁴⁸ Ligji për Përdorimin e Gjuhëve (02/L-37) (03/L-047), neni 7.6.

⁴⁹ Ligji për Përdorimin e Gjuhëve (02/L-37) (02/L-37), neni 9.

⁵⁰ Ligji për Përdorimin e Gjuhëve (02/L-37) (03/L-047), neni 2.4.

⁵¹ Ligji për Përdorimin e Gjuhëve (02/L-37) (02/L-37), neni 8.1.

⁵² Ligji për Përdorimin e Gjuhëve (02/L-37) (03/L-047), neni 8.2 dhe 8.3.

Përdorimi i gjuhëve në shërbime publike

Në ndërmarrjet që kryejnë shërbime publike, gjuhët zyrtare gëzojnë status të barabartë.⁵³

Ju keni të drejtë të komunikoni me ndërmarrje që ofrojnë shërbime publike në cilëndo gjuhë zyrtare në Kosovë, sa i përket ofrimit të shërbimeve dhe dhënies së dokumenteve nga to, përfshirë gjuhët zyrtare komunale dhe gjuhët në përdorim zyrtar në komunën e caktuar. Secila ndërmarrje e tillë është e obliguar që ta bëjë këtë lloj komunikimi të mundshëm.⁵⁴

Përdorimi i gjuhëve në sistemin e drejtësisë

Arrestimi dhe akuzat penale

Nëse arrestoheni apo ngarkoheni me ndonjë vepër penale, ju keni të drejtë që sa më shpejt dhe në një gjuhë që e kuptoni të informoheni për arsyet e arrestit dhe të ngarkimit të çfarëdo vepre ndaj jush.⁵⁵ Nëse jeni pjesëtar i komuniteteve gjuha amtare e të cilave nuk është një nga gjuhët zyrtare, ju këto informata do t'i merrni në gjuhën tuaj amtare.⁵⁶

Procedurat gjyqësore: përdorimi i gjuhëve zyrtare

Gjuhët zyrtare duhet të përdoren në baza të barabarta në të gjitha procedurat gjyqësore.⁵⁷

Nëse merrni pjesë në ndonjë procedurë penale ose procedura të tjera gjyqësore, autoritetet përkatëse (gjykatat, prokuroritë, etj.) duhet t'ju sigurojnë përdorimin e gjuhës zyrtare sipas zgjedhjes suaj.⁵⁸ Ju gjithashtu mund të kërkontë që procedurat t'ju përkthehen në mënyrë simultane nga një gjuhë zyrtare në tjetrën.⁵⁹

Procedurat gjyqësore: përdorimi i gjuhëve të tjera

Nëse jeni palë në procedura gjyqësore dhe nuk flisni dhe nuk kuptoni gjuhën (apo gjuhët) që në të përdoren, ju keni të drejtë të përdorni gjuhën tuaj. Nëse i përkisni një komuniteti gjuha amtare e të cilit nuk është një nga gjuhët

⁵³ Ligji për Përdorimin e Gjuhëve (02/L-37) (03/L-047), neni 30.1.

⁵⁴ Ligji për Përdorimin e Gjuhëve (02/L-37) (03/L-047), nenet 30.2, 30.3.

⁵⁵ Ligji për Përdorimin e Gjuhëve (02/L-37) (03/L-047), neni 15.1.

⁵⁶ Ligji për Përdorimin e Gjuhëve (02/L-37) (03/L-047), neni 15.2.

⁵⁷ Ligji për Përdorimin e Gjuhëve (02/L-37) (03/L-047), neni 12.1.

⁵⁸ Ligji për Përdorimin e Gjuhëve (02/L-37) (03/L-047), neni 12.2.

⁵⁹ Ligji për Përdorimin e Gjuhëve (02/L-37) (03/L-047), neni 13.1.

zyrtare, ju komunikimin do ta kryeni në gjuhën tuaj amtare.⁶⁰ Kjo e drejtë në veçanti zbatohet sa i përket të drejtës së parashtrimit të shkresave, dëshmimeve dhe dëgjimit të fakteve dhe dëshmimeve të rastit.⁶¹ Në këtë kuptim, autoritetet gjyqësore të përfshira në procedurë janë të obliguara t'ju sigurojnë përkthyes pa pagesë.⁶²

Gjykatat mund të lëshojnë dokumente në lidhje me procedurat në gjuhën zyrtare të zgjedhur për zhvillim të procedurës. Megjithatë, nëse ju jeni palë në procedurë, ju gjithashtu mund të kërkonti që dokumentet të lëshohen në gjuhët tjera zyrtare.⁶³

Burgosja

Institucionet penale dhe të burgimit duhet të sigurojnë që stafi i tyre të flasë gjuhën (apo gjuhët) që fliten apo kuptohen nga shumica e të burgosurve.

Nëse jeni burgosur, dhe mund të dëshmoni se keni nevojë gjegjëse, ju keni të drejtë t'ju sigurohet përkthim në një gjuhë të cilën e kuptoni.⁶⁴

Emrat personalë

Emrat dhe mbiemrat tuaj duhet vënë në dokumentet zyrtare (regjistrat publik, dokumente të identifikimit personal, etj.) në gjuhën zyrtare të cilën ju e zgjidhni. Shkrimi i këtyre të dhënave duhet bërë në alfabetin e gjuhës suaj të preferuar, dhe të bëhet në pajtim me traditën dhe sistemin gjuhësor të kësaj gjuhe. Forma që ju e zgjidhni duhet të shfrytëzohet nga zyrtarët publik.⁶⁵

Përdorimi i gjuhëve në sferën private

Në ndërmarrje private, institucione private, shoqata dhe organizata private dhe aktivitete vetëpunësuese ju keni të drejtë të përdorin gjuhën (apo gjuhët) që ju zgjedhni.⁶⁶

Megjithatë, në rastet kur gjuha nuk është gjuhë zyrtare ndërsa që aktivitetet në fjalë prekin interesin legjitim të publikut (rendin publik, sigurinë publike,

⁶⁰ Ligji për Përdorimin e Gjuhëve (02/L-37) (03/L-047), Nenet 16.2, 17.2.

⁶¹ Ligji për Përdorimin e Gjuhëve (02/L-37) (03/L-047), Nenet 16.1, 17.1.

⁶² Ligji për Përdorimin e Gjuhëve (02/L-37) (03/L-047), neni 16.3.

⁶³ Ligji për Përdorimin e Gjuhëve (02/L-37) (03/L-047), neni 14.

⁶⁴ Ligji për Përdorimin e Gjuhëve (02/L-37) (03/L-047), neni 18.

⁶⁵ Ligji për Përdorimin e Gjuhëve (02/L-37) (03/L-047), Nenet 27.1, 27.2.

⁶⁶ Ligji për Përdorimin e Gjuhëve (02/L-37) (03/L-047), neni 29.1.

shëndetin apo të drejtat e të tjerëve), institucionet e Kosovës do kërkojnë që të shfrytëzoni një nga gjuhët zyrtare.⁶⁷

2.7. Mediat

Mediat e hapura dhe të pavarura kanë rëndësi të veçantë në çdo shoqëri demokratike. Rëndësia e informatave dhe qasshmërisë së tyre për audiencën e gjerë është parakusht jetësor për të drejtat e lirisë së shprehjes dhe pjesëmarrjes politike.

Të drejtat e komuniteteve në media në Kosovë janë të ndërlidhura ngushtë me obligimet shtetërore të transmetuesit publik, i cili mëton të kanalizojë perspektivat e komuniteteve në transmetimet e lajmeve në vend; dhe me dispozitat speciale për një televizion në gjuhën serbe.

Të përgjithshme

Si pjesëtar i komuniteteve, ju dhe komuniteti juaj keni të garantuar qasjen pa diskriminim në informata.⁶⁸ Kjo qasje përfshin gazetat ditore dhe shërbimet elektronike. Ju gjithashtu keni të drejtë të shfrytëzimit të një numri të frekuencave të rezervuar në mediat elektronike.⁶⁹ Përveç kësaj, ju garantohet pranimi i lirshëm i transmetimeve ndërkufitare, qoftë në mënyrë direkte, qoftë përmes transmetimit apo ritransmetimit.⁷⁰

Megjithatë, vëreni se të gjitha këto të drejta i nënshtrohen rregullores që ndalon nxitjen apo shpërndarjen e urrejtjes apo jotolerancës racore, etnike apo fetare.⁷¹

Transmetuesi publik

Të gjitha komunitetet në Kosovë kanë të drejtë të përfaqësohen në mënyrë të barabartë në mediat që bëjnë transmetim publik, ndërsa që atyre ju alokohet koha për programet e komuniteteve të tyre në kanalet e transmetuesve publik.⁷² Në lidhje me minoritetin serb, Qeveria është e obliguar që të ndërmarrë “të gjitha masat brenda kompetencave të saj” për sigurimin e një plani ndërkombëtar të frekuencave që do t’i sigurojë komunitetit serb qasje

⁶⁷ Ligji për Përdorimin e Gjuhëve (02/L-37) (03/L-047), neni 29.2.

⁶⁸ Ligji për Komunitetet (03/L-047), neni 6.1.

⁶⁹ Ligji për Komunitetet (03/L-047), neni 6.1.

⁷⁰ Ligji për Komunitetet (03/L-047), neni 6.6.

⁷¹ Ligji për Komunitetet (03/L-047), neni 6.8.

⁷² Ligji për Komunitetet (03/L-047), neni 6.2.

në një kanal televiziv në gjuhën serbe, i cili të jetë i licencuar, i pavarur, me mbulim në mbarë Kosovën, dhe i cili të funksionojë në mënyrë efektive dhe pa diskriminim.⁷³ Radio Televizioni i Kosovës (RTK), institucioni për transmetim publik, është institucion i obliguar me ligj, dhe ka themeluar një kanal televiziv në shqip dhe një në serbisht.⁷⁴ Për më tepër, 10% e buxhetit të përgjithshëm të RTK-së, në baza vjetore, i alokohet kanalit televiziv të RTK-së në gjuhën serbe.⁷⁵

Sa u përket komuniteteve jo-serbe, të dy kanalet televizive të RTK-së duhet t'ia dedikojnë jo më pak se 15% të kohës së tyre të transmetimit të programeve në gjuhët e komuniteteve të tjera.⁷⁶ Komunitetet dhe pjesëtarët e tyre duhet të kenë rol udhëheqës në krijimin dhe prezantimin e këtyre programeve.⁷⁷

Politika e emetimit publik në Kosovë është e dizajnuar për të promovuar prodhimet nga mediat lokale, si dhe për të ofruar një sërë shërbimesh cilësore të emetimit. Gjithashtu ajo ka për qëllim të inkurajojë shpërndarjen më të gjerë të mundshme gjeografike, me qëllim të sigurimit të shërbimeve për të gjitha komunitetet në Kosovë. Alokimi i frekuencave të emetimit duhet të merr parasysh nevojat e komunitetit dhe kapacitetet e tregut, ndërsa që tërë programimi duhet të pasqyrojë barazinë mes qytetarëve dhe komuniteteve.⁷⁸

Komisioni i Pavarur për Media (KPM) është një organ politikisht neutral, përgjegjës për implementimin e kësaj politike. Ai përbëhet nga tri organe të ndara:

- Këshilli
- Zyra e Kryeshefit Ekzekutiv, dhe
- Bordi për Ankesa të Mediave.

Përbërja e Këshillit është relevante për komunitetet. Të paktën dy anëtarë të KPM-së duhet të emërohen nga pjesëtarët e komuniteteve dhe të paktën dy

⁷³ Ligji për Komunitetet (03/L-047), neni 6.5.

⁷⁴ Ligji për Radio-Televizionin e Kosovës (2011/04-L-046), neni 8.2

⁷⁵ ⁷⁵ Ligji për Radio-Televizionin e Kosovës (2011/04-L-046), neni 21.4.1

⁷⁶ ⁷⁶ Ligji për Radio-Televizionin e Kosovës, neni 8.3.

⁷⁷ Ligji për Komunitetet (03/L-047), neni 6.3.

⁷⁸ Ligji për Komisionin e Pavarur për Media (04/L-044), neni 9.4.

(2) anëtarë duhet të jenë të gjinisë femërore.⁷⁹ Të gjithë anëtarët e KPM-së emërohen nga Kuvendi i Kosovës.⁸⁰

Për më shumë detaje mbi procedurën e emërimeve, ju lutemi t'i referoheni Ligjit për Komisionin e Pavarur për Media (4/L-044), nenit 11.

Nëse dëshironi të parashtroni ankesë pranë KPM-së, ju lutemi të përcillni procedurën e sqaruar në kaptinën 2.14 më poshtë.

2.8. Arsimi

Arsimi është i rëndësishë kyçe për komunitetet në Kosovë, jo vetëm për shkak se përbën burim primar të njohurive dhe ideve për një gjeneratë të re, por edhe për shkak se ka implikime të mëdha praktike për qasje të barabartë në punësim, mundësi sociale dhe pjesëmarrje politike.

Krahas dispozitave që ndërlidhen me plan-programin kombëtar, të drejtat e komuniteteve për arsim në Kosovë janë të ndërlidhura ngushtë me të drejtat gjuhësore, në veçanti sa i përket gjuhës së mësimdhënies.

Plan-programi

Plan-programi kombëtar i arsimit në Kosovë duhet të mbulojë “historinë, kulturën dhe atributet tjera të komuniteteve që tradicionalisht janë të pranishme në vend, me qëllim të stimulimit të një fryme të respektit, mirëkuptimit dhe tolerancës mes të gjitha komuniteteve në Kosovë.”⁸¹ Në pajtim me këtë qëllim, synim i deklaruar i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) është “një sistem unik i arsimit në Kosovë, i cili respekton dallimet gjuhësore, kulturore, historike, artistike dhe tradicionale, përmes të cilave kultivohet identiteti kombëtar.”⁸² MASHT është aktualisht duke zhvilluar një plan-program të ri kombëtar, i cili është planifikuar të finalizohet në vitin 2018.

Sidoqoftë, duhet theksuar se komuniteti serb ka hezitur të marrë pjesë në zhvillimin dhe hartimin e programeve të reja mësimore, dhe, edhe nga 21 marsi 2013, edhe më tej vazhdon të punojë sipas kornizës së programeve të

⁷⁹ Ligji për Komisionin e Pavarur për Media (04/L-044), neni 10.5.

⁸⁰ Law on the Independent Media Commission (04/L-044), Article 11.1.

⁸¹ Ligji për Komunitetet (03/L-047), neni 8.12.

⁸² Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e Kosovës (MASHT), ‘Arsimimi dhe Integrimi i Komuniteteve’, ueb-faqja zyrtare e MASHT-it, në dispozicion në <http://www.masht.gov.net/advCms/#id=106> (qasur më 1 korrik 2009).

vetra arsimore të Serbisë. Dispozita të veçanta aplikohen për shkollat ku mësimi zhvillohet në gjuhën serbe (shih kaptinën më poshtë).

Gjuha e mësimdhënies

Siç u theksua më sipër, të drejtat në arsim të komuniteteve janë ngushtë të lidhura me të drejtat gjuhësore. Megjithëse e drejta në arsim fillor është e drejtë universale për tërë Kosovën⁸³, nëse i përkisni një komuniteti gjuha amtare e të cilit nuk është gjuhë e mësimdhënies në nivel kombëtar, ju nuk do të mund të gëzoni në tërësi këtë të drejtë fundamentale. Kjo do të përbënte diskriminim të tërthortë, sipas sqarimit të dhënë në kaptinën 2.2 më sipër.

Për këtë arsye, korniza legjislative e Kosovës përfshin një numër dispozitash për të siguruar që të gjithë nxënësit të kenë qasje në arsim në gjuhët e tyre amtare, në nivel parashkollor, fillor dhe të mesëm. Për më tepër, të gjithë nxënësit që kanë arsimuar në një gjuhë që nuk është gjuhë zyrtare e Kosovës janë të obliguar ta mësojnë një nga gjuhët zyrtare në Kosovë, në mënyrë që të kenë mundësi të barabarta në progresin e mëtejshëm të tyre në arsimimin e lartë.

E drejta në arsim në një nga gjuhët zyrtare të Kosovës

Në të gjitha nivelet e arsimimit ju keni të drejtë të zgjedhni për vete apo për fëmijët tuaj gjuhën e preferuar zyrtare të mësimdhënies.⁸⁴

Nëse jeni nxënës, ju mund të vendosni, krahas prindërve tuaj, në cilën gjuhë zyrtare do t'i mbajë shkolla regjistrat tuaj shkollor.⁸⁵

Mësimi në gjuhën serbe

Ekzistojnë dispozita të veçanta sa i përket mësimin në gjuhën serbe, dhe komunave ju lejohet krijimi i kushteve për të ofruar këtë lloj arsimimi.⁸⁶ Për të bërë këtë, ato gjithashtu kanë të drejtë të bashkëpunojnë me komuna dhe institucione të Republikës së Serbisë, përfshirë agjencitë qeveritare.⁸⁷

⁸³ Kushtetuta, neni 47.

⁸⁴ Ligji për Komunitetet (03/L-047), neni 8.1; Ligji për Përdorimin e Gjuhëve (02/L-37), neni 19.2.

⁸⁵ Ligji për Përdorimin e Gjuhëve (02/L-37) (02/L-37), neni 24.1.

⁸⁶ Ligji për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës (03/L-068) (03/L-068), neni 12.1.

⁸⁷ Ligji për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës (03/L-068), neni 4.3.

Nëse një shkollë do që të ofrojë mësim në gjuhën serbe, ajo mundet që, bazuar në kushte të caktuara, të aplikojë plan-programet dhe të shfrytëzojnë tekstet shkollore të përpiluar nga Ministria e Arsimit e Republikës së Serbisë.⁸⁸

Kompetencat e shtuara për arsim të lartë

Komuna e Mitrovicës Veriore ka kompetenca të shtuara në fushën e arsimit të lartë, ndërsa që Universiteti i Mitrovicës Veriore është shpallur institucion autonom publik i arsimit të lartë në gjuhën serbe.⁸⁹

Komuna e Mitrovicës Veriore është përgjegjëse për universitetin.⁹⁰ Ajo duhet të sigurojë se universiteti do të gëzojë premisa dhe financim adekuat për të kryer funksionet e veta nga buxheti i Kosovës dhe nga burimet tjera institucionale. Universiteti gjithashtu mund të pranojë fonde nga Qeveria e Republikës së Serbisë, me kusht që kjo të bëhet në mënyrë transparente, publike dhe në pajtim me ligjet e Kosovës.⁹¹

Megjithatë, deri në prill 2013, për shkak të pengesave politike, Komuna e Mitrovicës Veriore ende nuk është themeluar zyrtarisht dhe Universiteti i Mitrovicës Veriore vazhdon të funksionojë në kuadër të sistemit të arsimit të Serbisë.

Arsimimi në gjuhët e komuniteteve që nuk janë gjuhë zyrtare

Arsimi publik parashkollor, fillor dhe i mesëm

Nëse jeni pjesëtar i një komuniteti gjuha e të cilit nuk është gjuhë zyrtare, ju keni të drejtë në arsimim publik parashkollor, fillor dhe të mesëm në gjuhën tuaj amtare.⁹² Megjithatë, ju gjithashtu duhet të mësoni një gjuhë zyrtare, sipas zgjedhjes tuaj.⁹³ Nëse vijoni mësimin në gjuhë të komunitetit që nuk është gjuhë zyrtare, keni të drejtë të merrni raportet dhe vërtetimet përkatëse të lëshuara në gjuhën tuaj, sikur edhe që regjistrat tuaj të mbahen në atë gjuhë.⁹⁴

Lëndët dhe mësimi në gjuhën e komunitetit duhet të themelohen në bazë të pragjeve të arsyeshme dhe të qëndrueshme, të përcaktuara nga Qeveria.

⁸⁸ Ligji për Arsimin në Komunitetet e Republikës së Kosovës (03/L-068), neni 12.4.

⁸⁹ Ligji për Arsimin në Komunitetet e Republikës së Kosovës (03/L-068), neni 14.

⁹⁰ Ligji për Arsimin në Komunitetet e Republikës së Kosovës (03/L-068), nenet 14.d.

⁹¹ Ligji për Arsimin në Komunitetet e Republikës së Kosovës (03/L-068), nenet 14.e.

⁹² Ligji për Komunitetet (03/L-047), neni 8.1; Ligji për Përdorimin e Gjuhëve (02/L-37), neni 20.1.

⁹³ Ligji për Komunitetet (03/L-047), neni 8.10; Ligji për Përdorimin e Gjuhëve (02/L-37), neni 21.

⁹⁴ Ligji për Përdorimin e Gjuhëve (02/L-37), neni 24.3.

Megjithatë, në rast kur këto pragje nuk përmbushen, Qeveria ka për obligim të ofrojë alternativa. Këto alternativa përfshijnë:

- Transport të subvencionuar për në zonat ku ofrohet arsimim i tillë,
- Mësim nga distanca,
- Aranzhime të mësimdhënies në rotacion, ose
- Oferta për vendosje dhe qëndrim.⁹⁵

Në rastet kur arsimimi ofrohen në gjuhë të komunitetit që nuk është gjuhë zyrtare, Qeveria është përgjegjëse për përcaktimin e një plan-programi të integruar për monitorimin dhe zhvillimin e cilësisë së arsimit të ofruar.⁹⁶

Entitetet që ofrojnë arsim në gjuhë të komuniteteve që nuk janë gjuhë zyrtare mund të dizajnojnë programet e veta shkollore. Megjithatë, ato duhet të jenë në pajtim me plan-programin e integruar të hartuar nga Qeveria, dhe duhet të përmbushin standardet që ai plan-program thekson se do të arrijë. Ngjashëm, komunitetet kanë të drejtë të gjenerojnë module arsimore lidhur me kulturën, historinë dhe traditën e tyre, në bashkëpunim me Qeverinë.⁹⁷

Qeveria është përgjegjëse për sigurimin e personelit të mjaftueshëm dhe të kualifikuar. Trajnimet e mësimdhënësve duhet kryer në gjuhët relevante për ata që kërkojnë të japin mësim në shkolla që mësimin e zhvillojnë në gjuhë të komuniteteve.⁹⁸

Qeveria duhet të sigurojë që udhëheqësit dhe mësimdhënësit në institucione publike arsimore që veprojnë në gjuhë të komuniteteve të jenë kryesisht përfaqësues të po atyre komuniteteve dhe të jenë plotësisht të njohur me identitetin e tyre.⁹⁹

Arsimi i lartë dhe trajnimet përkatëse

Nëse i përkisni një komuniteti gjuha e të cilit nuk është gjuhë zyrtare, Shteti ka për obligim të garantojë lehtësira ekzistuese për trajnim profesional dhe arsimin të lartë në atë gjuhë. Për më tepër, nëse komuniteti shpreh nevojën për arsimim të lartë dhe programe të trajnimit profesional në gjuhën e

⁹⁵ Ligji për Komunitetet (03/L-047), neni 8.2

⁹⁶ Ligji për Komunitetet (03/L-047), neni 8.7.

⁹⁷ Ligji për Komunitetet (03/L-047), neni 8.7.

⁹⁸ Ligji për Komunitetet (03/L-047), neni 8.8.

⁹⁹ Ligji për Komunitetet (03/L-047), neni 8.9.

komunitetit tuaj, shteti duhet t'i sigurojë ato, me kusht që kjo të vlerësohet financiarisht e arsyeshme.¹⁰⁰

Pjesëtarët e komuniteteve e kanë të garantuara nga Qeveria qasjen e barabartë në arsim të lartë, ngase kjo e fundit ka për obligim të përcaktojë “masa të posaçme” për të siguruar pranimin e kandidatëve nga shkollat e komuniteteve në institucionet universitare apo të arsimit të lartë.¹⁰¹ Çdo vit akademik, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) rezervon një numër vendesh në universitetet publike për studentë nga komunitetet minoritare.

Institutet private arsimore dhe trajnuese në gjuhët e komunitetit

Nëse jeni pjesëtar i një komuniteti, ju dhe komuniteti juaj keni të drejtë të krijoni dhe menaxhoni institute private arsimore dhe trajnuese, për të cilat mund të përfitoni nga asistenca financiare publike.

Këto veprimtari mund të aplikojnë për akreditim tek MASHT, me kusht që të vepronë në pajtim me standardet e përgjithshme arsimore të plan-programit të përgjithshëm të Kosovës. Me këtë rast, MASHT është përgjegjës për monitorimin e cilësisë së arsimit të ofruar.¹⁰²

2.9. Mundësitë ekonomike dhe sociale

Edhe pse diskriminimi direkt dhe i tërthortë ndaj personave që u përkasin komuniteteve vazhdon të ndodh në jetën ekonomike dhe sociale, dispozitat legjislative mbi mundësitë ekonomike dhe sociale janë mjaft të pazhvilluara nëse krahasohen me gjendjen reale. Anash obligimeve të përgjithshme të Shtetit për të promovuar barazi të plotë dhe efektive, vëmendja është parimisht e fokusuar në punësim.

Të përgjithshme

Në përgjithësi, Shteti duhet të ndër marrë “masa adekuate” për të promovuar barazi të plotë dhe efektive në jetën ekonomike dhe sociale.¹⁰³ Qasja në punësim, mbrojtje sociale dhe banim janë theksuar si fusha të rëndësishme së veçantë.¹⁰⁴

¹⁰⁰ Ligji për Komunitetet (03/L-047), neni 8.3.

¹⁰¹ Ligji për Komunitetet (03/L-047), neni 8.11.

¹⁰² Ligji për Komunitetet (03/L-047), neni 8.4; Ligji për Përdorimin e Gjuhëve (02/L-37), neni 22.

¹⁰³ Kushtetuta, neni 58.4.

¹⁰⁴ Ligji Kundër Diskriminimit, Nenet 4.a, 4.c, 4.e, 4.h.

Si pjesëtar i komunitetit, ju keni të drejtë specifike të gëzoni pronën tuaj, dhe të merrni kompensim të drejtë dhe të barabartë për punën që kryeni, pa iu nënshtruar diskriminimit.¹⁰⁵

Nëse jeni edhe pjesëtar i një komuniteti edhe grua, i nënshtroheni rrezikut të 'diskriminimit të dyfishtë' në dy baza, të gjinisë dhe përkatësisë në një komunitet. Shteti ka për obligim që të miratojë masa të veçanta për t'iu kundërvënë diskriminimit të tillë.¹⁰⁶

Punësimi

Parimi i mos-diskriminimit në bazë të asociimit me një komunitet kombëtar është një nga parimet udhëzuese të shërbimit civil.¹⁰⁷

Shteti duhet të zhvillojë programe të punësimit publik dhe masa tjera të posaçme që kanë për qëllim punësimin. Nëse jeni pjesëtar i komuniteteve Rom, Ashkali apo Egjiptas, ju gëzoni kujdes të posaçëm sa i përket kësaj.¹⁰⁸

Pjesëtarët e komuniteteve kanë të drejtë të përfaqësohen në mënyrë të barabartë në punësim në të gjitha nivelet e ndërmarrjeve publike (NP) dhe institucioneve publike (përfshirë sektorin e sigurisë, gjyqësisë, prokuroritë, agjencitë qeveritare për administrim të drejtësisë dhe shërbimin korrektues, të mbrojtjes, sigurisë dhe inteligjencës).¹⁰⁹ Për më tepër, përmirësimi i qasjes së komuniteteve në mundësi ekonomike dhe të punësimit duhet realizuar me pjesëmarrje të plotë dhe në konsultim me organizatat përfaqësuese të komuniteteve.¹¹⁰

Sa i përket punësimit, pozitat e hapura duhet të reklamohen gjerësisht në gjuhën shqipe dhe serbe. Autoritetet punëdhënëse duhet të formojnë panele me tre (3) apo më shumë anëtarë, të cilët denjësisht përfaqësojnë komunitetet në Kosovë, për shqyrtimin e aplikacioneve për punësim, parakualifikimin, intervistimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve.¹¹¹

¹⁰⁵ Ligji për Komunitetet (03/L-047), neni 9.1.

¹⁰⁶ Ligji për Komunitetet (03/L-047), neni 9.4.

¹⁰⁷ Rregullorja nr. 2001/36 mbi Shërbimin Civil të Kosovës, neni 2.1.g.

¹⁰⁸ Ligji për Komunitetet (03/L-047), neni 9.2.

¹⁰⁹ Ligji për Komunitetet (03/L-047), neni 9.5.

¹¹⁰ Ligji për Komunitetet (03/L-047), neni 9.3.

¹¹¹ Rregullorja nr. 2001/36 mbi Shërbimin Civil të Kosovës, Nenet 3.1.a-b.

Bordi i Pavarur Mbikëqyrës është krijuar për t'u marrë me situata për të cilat pohohet se punëdhënësit kanë shkelur parimin e mos-diskriminimit në bazë të përkatësisë në një pakicë kombëtare. Për detaje të mëtejme lidhur me parashtrimin e ankesave të tilla, ju lutemi referojuni kaptinës 2.14 më poshtë.

Nëse jeni pjesëtar i një komuniteti dhe e keni të vështirë t'i plotësoni standardet për t'u pranuar në vende pune në shërbim publik, e në veçanti në vende në nivel më të lartë, ju keni të drejtë të shfrytëzoni masa të caktuara të veçanta.¹¹² Për shembull, të gjitha autoritetet punëdhënëse mund të shfrytëzojnë, sipas nevojës, masat vijuese afirmative:

- *Rekrutimi aktiv.* Punëdhënësi mund të bëjë përpjekje të posaçme për të identifikuar dhe marrë aplikacione për vende pune nga pjesëtarët e komuniteteve të nën-përfaqësuara, në veçanti mes personave të zhvendosur dhe refugjatëve.
- *Adresimi i rezultateve të diskriminimit afatgjatë.* Punëdhënësi mund të sajorë programe të trajnimit në vend të punës për komunitete që zakonisht janë në disavantazh, për të përmirësuar gjasat e tyre në aplikim dhe konkurrim për promovim. Trajnimi duhet të ofrohet në mënyrë të barabartë për të gjithë shërbyesit civilë, të të gjitha etnive dhe të dyja gjinive.
- *Adresimi i diskriminimit përmes trajnimit dhe mekanizmave përkatës rregullativ.* Punëdhënësi duhet të sigurohet që personeli të kuptojë politikat kundër diskriminimit dhe të ketë qasje në procedura adekuate në rast të pakënaqësive.¹¹³

Krahas kësaj, komunat dhe agjencitë ekzekutive janë të obliguara të përgatisin deklaratat politike për mundësi të barabarta (DPMB) dhe strategjitë implementuese përkatëse. DPMB duhet të arrijnë disa objektiva të caktuara, siç janë:

- Inkurajimin e aplikimit të personave që u përkasin komuniteteve të nën-përfaqësuara të Kosovës, përfshirë pjesëtarët e komuniteteve pakicë;
- Promovimin e të kuptuarit dhe shfrytëzuarit të të dyja gjuhëve zyrtare të Kosovës nga punonjësit; dhe

¹¹² Ligji për Komunitetet (03/L-047), neni 9.6.

¹¹³ Urdhëresa Administrative nr 2003/2 për implementimin e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/36 mbi Shërbimin Civil në Kosovë, Nenet 10.1(a)-(c).

- Sigurimin që të gjithë qytetarëve tu ofrohen shërbimet civile të të njëjtës cilësi.¹¹⁴

2.10. Shëndetësia

Të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre për kujdes shëndetësor kryesisht kanë të bëjnë me njohjen e kualifikimeve mjekësore dhe përkthimin e informatave mjekësore në gjuhët e komunitetit, si dhe qasje të barabartë në kujdes shëndetësor. Këtu përfshihen edhe disa të drejta më të avancuara sa i përket kompetencave të shtuara për disa komuna në ofrimin e kujdesit sekondar shëndetësor.

Të përgjithshme

Nëse jeni pjesëtar i një komuniteti ju keni të drejtë të qasjes së barabartë dhe pa diskriminim ndaj kujdesit shëndetësor. Shteti duhet të ndërmarrë “masat e domosdoshme” për të siguruar këtë.¹¹⁵ Në veçanti, shteti obligohet të përcaktojë procedura efektive, transparente, që sigurojnë pjesëmarrje dhe qasje për të monitoruar qasjen në kujdes shëndetësor dhe ofrimin e shërbimeve shëndetësore për pjesëtarët e komuniteteve.¹¹⁶ Kujdes i veçantë duhet t’i kushtohet sigurimit të shërbimeve të kënaqshme shëndetësore për personat që i përkasin komuniteteve më të cënueshme nga aspekti social dhe ekonomik.¹¹⁷

Nëse jeni pjesëtar i komuniteteve, ju keni të drejtë të informoheni sa i përket edukimit shëndetësor, përfshirë informatat mbi të drejtat dhe obligimet tuaja, të cilat duhet t’ju ofrohen dhe të postohen në gjuhën e komunitetit tuaj.¹¹⁸ Udhëzimet për siguri shëndetësore duhet gjithashtu të vihen në dispozicionin tuaj në gjuhën tuaj.¹¹⁹

Republika e Kosovës duhet të njeh kualifikimet mjekësore të marra jashtë vendit, në veçanti ato të personave që flasin gjuhët e komuniteteve, me kusht që ato të jenë marrë në pajtim me standardet ndërkombëtare të akreditimit.¹²⁰

¹¹⁴ MShP DCSA AI 2003/12 mbi Procedurat e Mundësive të Barabarta, në dispozicion në <http://www.ks.gov.net/mshp/Documents/No.MPS-DCSA-2003-12.pdf> (qasur më 1 korrik 2009).

¹¹⁵ Ligji për Komunitetet (03/L-047), neni 10.1.

¹¹⁶ Ligji për Komunitetet (03/L-047), neni 10.6.

¹¹⁷ Ligji për Komunitetet (03/L-047), neni 10.2.

¹¹⁸ Ligji për Komunitetet (03/L-047), neni 10.5.

¹¹⁹ Ligji për Komunitetet (03/L-047), neni 10.3.

¹²⁰ Ligji për Komunitetet (03/L-047), neni 10.4.

Kompetencat e shtuara komunale

Komunave të Mitrovicës Veriore, Graçanicës dhe Shtërpçës u janë akorduar kompetenca të shtuara në këtë fushë dhe rrjedhimisht janë përgjegjëse për ofrimin e kujdesit shëndetësor dytësor. Kjo përfshin regjistrimin dhe licencimin e institucioneve që ofrojnë shërbime shëndetësore, rekrutimin, pagimin e pagave dhe trajnimin e personelit shëndetësor dhe administratorëve përkatës.¹²¹

2.11. Pjesëmarrja politike

Dispozitat për pjesëmarrje efektive politike të komuniteteve janë kyçe për funksionimin e duhur të një shoqërie shumë-etnike. Vetëm përmes pjesëmarrjes efektive politike mund t'i jepet kujdesi i duhur shqyrtimit të interesave të ndryshëm të komuniteteve të ndryshme, në kontekst të vendimmarrjes dhe zhvillimit të ligjeve dhe programeve qeveritare.

Si rrjedhojë, korniza legislative në Kosovë u ka dhënë komuniteteve dhe pjesëtarëve të komuniteteve të drejta të avancuara për pjesëmarrje efektive. Këto të drejta përfshijnë të drejtat për formimin e partive politike, dhe të përfaqësimit në të gjitha nivelet e qeverisë.

Në institucionet e Kosovës, pjesëmarrja e komuniteteve shtrihet edhe në 'vertikalisht' edhe 'horizontalisht':

- Vertikalisht, nga niveli më i lartë i qeverisë qendrore deri tek nivelet më ulëta komunale e lokale; dhe
- Horizontalisht, përgjatë të gjitha fushave politike, posaçërisht relevante për komunitetet (p.sh. në arsim, gjuhë, religjion dhe trashëgimi kulturore, etj).

Në qeverinë qendrore, pjesëmarrja e komuniteteve sigurohet përmes përfaqësimit të garantuar në Kuvend të Kosovës, në Qeveri, në gjyqësi dhe organe tjera.¹²²

Në nivelin komunal, komunitetet kanë të drejtë të gëzojnë përfaqësim në organet komunale legislative dhe ekzekutive.

¹²¹ Ligji për Vetëqeverisje Lokale (03/L-040), neni 20.

¹²² Ligji për Komunitetet (03/L-047), neni 11.1.

Së fundmi, OPK-të inkurajohen t'u ndihmojnë komuniteteve përkatëse në përfaqësimin e interesave të tyre përkatëse në mënyrë të konsoliduar, në radhë të parë përmes Këshillit Konsultativ për Komunitete.¹²³

Partitë politike

Pjesëtarët e komuniteteve kanë të drejtë të formojnë parti politike dhe të kandidohen për pozita të zgjedhura në të gjitha nivelet e qeverisë.¹²⁴

Si rregull, partitë politike nuk mund të përjashtojnë individët për shkak të përkatësisë në komunitete. Megjithatë, një përjashtim i rëndësishëm nga ky rregull aplikohet në rastet kur pjesëtarët e komuniteteve vendosin të krijojnë parti me qëllim të përfaqësimit të komunitetit të tyre.¹²⁵

Niveli qendror

Dega legjislative

Kuvendi i Kosovës

Njëzet (20) nga njëqindnjëzet (120) ulëse të Kuvendit të Kosovës janë të garantuara për përfaqësim të komuniteteve që nuk përbëjnë shumicën në Kosovë. Këto ulëse janë të shpërndara mes komuniteteve si vijon:

- Komuniteti serb në Kosovë ka të drejtë në së paku dhjetë (10) ulëse të garantuara (edhe nëse numri i ulëseve të fituara në zgjedhje të hapura është më i vogël se dhjetë (10));
- Komunitetet tjera gjithashtu kanë të drejtë të mbajnë numrin minimal të ulëseve, si vijon:
 - Tri (3) ulëse për komunitetin Boshnjak,
 - Dy (2) ulëse për komunitetin Turk,
 - Një (1) ulëse për komunitetin Goran,
 - Një (1) ulëse për komunitetin Rom,
 - Një (1) ulëse për komunitetin Ashkali
 - Një (1) ulëse për komunitetin Egjiptian
 - Një (1) ulëse shtesë për komunitetin Rom, Ashkali apo Egjiptian, varësisht nga numri më i lartë i votave të përgjithshme.¹²⁶

¹²³ Ligji për Komunitetet (03/L-047), neni 11.5.

¹²⁴ Ligji për Komunitetet (03/L-047), neni 11.3.

¹²⁵ Ligji për Komunitetet (03/L-047), neni 11.4.

¹²⁶ Kushtetuta, neni 64.2.

Përfaqësimi i kroatëve dhe malazëve në Kuvend:

Komunitete kroat dhe ai malazez janë njohur shprehimisht vetëm përmes plotësim-ndryshimit të Ligjit mbi Komunitetet, më 8 dhjetor 2011, dhe për pasojë nuk kanë të drejtë të gëzojnë një numër minimal të ulëseve.

Kushtetuta mund të ndryshohet vetëm me dy të tretat (2/3) e votave të të gjithë deputetëve. Këtu përfshihen edhe dy të tretat (2/3) e deputetëve që mbajnë ulëset e rezervuara që u garantohen përfaqësuesve të komuniteteve pakicë.¹²⁷

Dy (2) zëvendëskryetarë të Kuvendit duhet të jenë përfaqësues të komuniteteve jo-shumicë. Ata zgjidhen me shumicë të votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit, ndërsa njëri duhet të jetë deputet që mban ulëse të rezervuar për komunitetin serb e tjetri deputet që mban ulëse të rezervuar për komunitetet tjera jo-shumicë.¹²⁸

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim (KDIKK)

KDIKK është komisioni i përhershëm i Kuvendit që ka për detyrë vlerësimin e pajtueshmërisë së legjislacionit të propozuar me të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Përbërja e tij është si në vijim:

- Një e treta (1/3) e anëtarëve që mbajnë ulëse të rezervuara për komunitetin serb,
- Një e treta (1/3) e anëtarëve që mbajnë ulëse të rezervuara për komunitetet tjera pakicë, dhe
- Një e treta (1/3) e anëtarëve nga komuniteti shumicë.¹²⁹

Procedura e të njëjtit është si në vijim:

- Të gjitha ligjet e propozuara mund të dorëzohen tek KDIKK për të marrë opinionin këshillëdhënës të tij, nga cilido anëtar i Kryesisë së Kuvendit, nga komisionet tjera apo nga një grup prej së paku dhjetë (10) deputetëve. Komisioni gjithashtu mund të propozojë ligje dhe

¹²⁷ Kushtetuta, neni 65.2.

¹²⁸ Kushtetuta, neni 67.4.

¹²⁹ Kushtetuta, neni 78.1.

masa tjera sipas iniciativës vetanake, duke iu përmbajtur funksioneve të Kuvendit.¹³⁰

- Komisioni mund të bëjë rekomandime lidhur me ligjet e propozuara, për t'u siguruar se të drejtat dhe interesat e komuniteteve janë adresuar si duhet.¹³¹ Anëtarët e tij gjithashtu mund të japin opinione individuale.¹³² Ai duhet të vendosë nëse do të lëshojë rekomandim apo jo me shumicë të votave të anëtarëve të tij, brenda dy javësh.¹³³
- Rekomandimet mund t'i dorëzohen komisionit tjetër relevant apo Kuvendit.¹³⁴

Informatat për kontakt

Ndërtesa e Qeverisë, Kati VI, nr. 605A

Koordinatorë e Komisionit:

Tel: +381 38 211 295

Email: natasa.prica@assembly-kosova.org

Legjislacioni me interes vital

Disa çështje dhe fusha konsiderohet të jenë me interes vital për komunitetet dhe pjesëtarët e tyre. Për këtë arsye, për miratimin, ndryshimin apo shfuqizimin e ligjeve që lidhen me këto fusha kërkohet ' shumicë e dyfishtë'. Kjo nënkupton:

- Shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit (që janë të pranishëm dhe votojnë), dhe
- Shumicën e votave të deputetëve të Kuvendit që mbajnë ulëset e rezervuara për përfaqësuesit e komuniteteve pakicë (të pranishëm dhe që votojnë).¹³⁵

Këto fusha të interesit jetësor janë specifikuar në vijim:

- Ligjet për ndryshimin e kufijve komunal, që themelojnë apo shfuqizojnë komuna, që definojnë fushëveprimin e autorizimeve komunale,
- Ligjet për implementimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre, përveç atyre të përcaktuara me Kushtetutë,

¹³⁰ Kushtetuta, neni 78.4.

¹³¹ Kushtetuta, neni 78.3.

¹³² Kushtetuta, neni 78.4.

¹³³ Kushtetuta, neni 78.2.

¹³⁴ Kushtetuta, neni 78.3.

¹³⁵ Kushtetuta, neni 81.1.

- Ligjet për përdorimin e gjuhëve,
- Ligjet për zgjedhje lokale,
- Ligjet për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore,
- Ligjet për lirinë e religjionit apo për marrëveshjet me komunitetet fetare,
- Ligjet për arsimin, dhe
- Ligjet për përdorimin e simboleve, përfshirë simbolet e komuniteteve dhe ligjet për festat publike.¹³⁶

Qeveria e Kosovës

Në përbërjen e Qeverisë duhet të ketë:

- Së paku një (1) ministër nga komuniteti serb i Kosovës dhe një (1) ministër nga komunitetet tjera pakicë (nëse ka më shumë se dymbëdhjetë (12) ministra, në Qeveri duhet të ketë edhe ministrin e tretë që përfaqëson komunitetet pakicë),¹³⁷
- Së paku dy (2) zëvendësministra nga komuniteti serb i Kosovës dhe dy (2) zëvendësministra nga komunitetet tjera jo-shumicë (nëse ka më shumë se dymbëdhjetë (12) ministra, Qeveria duhet të ketë edhe zëvendësministrin e tretë që përfaqëson një komunitet tjetër jo-shumicë).¹³⁸

Përzgjedhja e këtyre ministrave dhe zëvendësministrave duhet përcaktuar pas konsultimit me parti, koalicione apo grupe që përfaqësojnë komunitetet pakicë. Nëse ata nuk janë deputetë të Kuvendit të Kosovës, ata duhet të miratohen formalisht nga shumica e deputetëve të Kuvendit, duke theksuar se ata duhet të përfaqësojnë komunitetin në fjalë.¹³⁹

Këshilli Konsultativ për Komunitete

KKK, organ i mandatuar me Kushtetutë, në kuadër të Zyrës së Presidentit¹⁴⁰, është menduar të jetë mekanizëm kyç për të lehtësuar pjesëmarrjen politike të komuniteteve në nivelin qendror. KKK përbëhet kryesisht nga përfaqësues të të gjitha komuniteteve minoritare dhe ata të Qeverisë së Kosovës dhe

¹³⁶ Kushtetuta, Neni 81.1

¹³⁷ Kushtetuta, neni 96.3.

¹³⁸ Kushtetuta, neni 96.4.

¹³⁹ Kushtetuta, Neni 96.5.

¹⁴⁰ The CCC's mandate is based on Article 60 of the Constitution, Article 12 of the Law on Communities (03/L-047) and the Statute of the CCC, adopted by Presidential Decree on 18 April 2012.

institucioneve të tjera relevante publike. Përfaqësuesit e komuniteteve dominohen nga OPK-të dhe emërohen nga Presidenti i Kosovës. Funkcionet e KKK-së përfshijnë:

- T'u ofrojë komuniteteve mundësinë për të marrë pjesë, në një fazë të hershme, në nismat legjislative dhe të politikave që përgatiten nga Qeveria ose Kuvendi, për të propozuar nisma të tilla dhe që pikëpamjet e tyre të përfshihen në projekte dhe programe përkatëse, përfshirë strategjinë dhe raportin vjetor;
- T'u mundësojë komuniteteve të marrin pjesë në vlerësimin e nevojave, dhe në hartimin, monitorimin dhe vlerësimin e programeve që kanë për objektiv pjesëtarët e tyre ose që janë me rëndësi të veçantë për ta;
- Të japë rekomandime gjatë procesit të vendimmarrjes në lidhje me ndarjen e fondeve për projekte për komunitetet, nga fondet ndërkombëtare dhe ato të buxhetit të vendit; dhe
- Të ngritë vetëdijen për problemet me të cilat përballen komunitetet në Kosovë dhe të kontribuojë në marrëdhëniet harmonike ndërmjet të gjitha komuniteteve.

Bëhuni pjesë e KKK-së:

Secili përfaqësues i një komuniteti minoritar potencialisht mund të bëhet anëtar i KKK-së. Ky proces ju kërkon që të nominoheni nga një OShC e komunitetit që është e akredituar nga Sekretariati i KKK-së, e ashtuquajtur Organizatë Përfaqësuese e Komunitetit (OPK). Pas këtij nominim, Presidenti i Kosovës emëron kandidatin e nominuar anëtar të KKK-së, për një mandat dyvjeçar. Cilado OShC që përfaqëson interesat e një komuniteti jo-shumicë mund të akreditohet nga Sekretariati i KKK-së, nëse përmbushin kriteret e përcaktuara me Statutin e KKK-së. Kjo i mundëson OShC-së përkatëse që të nominojë kandidatët për anëtarë të KKK-së. Për më tepër, ju lutemi vizitoni ueb-faqen e KKK-së: <http://www.ccc-president-ksgov.net>.

Informatat për kontakt

Sekretar: Avni Bahtijari

Tel: +377 44 747064

Email: avnija.bahtijari@president-ksgov.net

Gjyqësori

Gjykata Supreme dhe Gjykatat e Apelit

Në Gjykatën Supreme, së paku 15% e gjykatësve duhet të vijnë nga komunitetet pakicë (jo më pak se tre (3)).¹⁴¹

Në të gjitha gjykatat tjera me juridiksion apeli, së paku 15% e gjykatësve duhet të vijnë nga komunitetet pakicë (jo më pak se dy (2)).¹⁴²

Gjykata Kushtetuese

Propozimi i dy (2) nga nëntë (9) gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese kërkon votat e dy të tretës (2/3) së deputetëve të Kuvendit (të pranishëm dhe që votojnë) dhe pajtimin tjetër të shumicës së deputetëve të Kuvendit që mbajnë ulëse të rezervuara për përfaqësuesit e komuniteteve pakicë.¹⁴³

Këshilli Gjyqësor i Kosovës

Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) është përgjegjës për rekrutimin e kandidatëve për t'u emëruar në gjyqësor. Ai ka mandat për t'i 'dhënë preferencë në emërim gjyqtarëve pjesëtarë të komuniteteve të cilët janë të nën-përfaqësuar në gjyqësor, në pajtim me ligjin".¹⁴⁴

Përbërja e tij është si në vijim:

- Dy (2) nga trembëdhjetë (13) anëtarët e tij duhet të zgjedhen nga deputetët e Kuvendit që mbajnë ulëset e rezervuara për komunitetin Serb, dhe
- Dy anëtarë tjerë duhet të zgjedhen nga deputetët e Kuvendit që mbajnë ulëset e rezervuara për komunitetet tjera jo-shumicë.¹⁴⁵

Procedura e emërimit të të njëjtit është si në vijim:

¹⁴¹ Kushtetuta, neni 103.3.

¹⁴² Kushtetuta, neni 103.6.

¹⁴³ Kushtetuta, neni 114.3.

¹⁴⁴ Kushtetuta, neni 108.1-108.3.

¹⁴⁵ Kushtetuta, Nenet 6.3, 6.44.

- Emërimet në pozita gjyqësore të rezervuara për pjesëtarë të komunitetit jo-shumicë mund të rekomandohen vetëm nga shumica e anëtarëve të Këshillit që janë emëruar nga deputetët e Kuvendit që mbajnë ulëse të rezervuara për pjesëtarë të komunitetit jo-shumicë. Megjithatë, nëse ky grup nuk e rekomandon një kandidat për një pozitë të caktuar në dy seanca të njëpasnjëshme, cilido anëtar i Këshillit mund ta bëjë atë.¹⁴⁶
- Ekzistojnë procedura të veçanta për gjykatat themelore që kanë juridiksion ekskluziv mbi një apo më shumë komuna në të cilat komuniteti serb përbën shumicën. Emërimi i kandidatëve për gjyqtarë në ato zona mund të rekomandohet nga dy (2) anëtarë të Këshillit të zgjedhur nga deputetët e Kuvendit të cilët mbajnë ulëse të rezervuara për komunitetin serb (të cilët veprojnë bashkërisht dhe në mënyrë unanime). Megjithatë, nëse këta anëtarë nuk arrijnë ta rekomandojnë një kandidat në dy seanca të njëpasnjëshme, cilido anëtar i Këshillit mund ta bëjë këtë.¹⁴⁷

Këshilli Prokurorial i Kosovës

Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) është organ i paraparë të rekrutojë, propozojë, promovojë, transferojë, riemërojë, dhe disiplinon prokurorët e Shtetit. Me politikën rekrutuese të këtij organi, Këshilli obligohet t'i jap përparësi emërimit të anëtarëve nga komunitetet e nën-përfaqësuar.¹⁴⁸

Niveli komunal

Në vijim janë listuar disa nga mekanizmat më të rëndësishëm komunalë për mbrojtjen he provimin e të drejtave dhe interesave të komuniteteve minoritare në nivelin komunal..

Zëvendëskryesuesi për Komunitete (ZKK)

Shih gjithashtu kaptinën 2.13 më poshtë.

Në komunat ku së paku 10% të qytetarëve të saj u përkasin komuniteteve jo-shumicë në atë komunë, posti i Zëvendëskryesuesit për Komunitete (ZKK) do të rezervohet për përfaqësuesit e këtyre komuniteteve.¹⁴⁹

¹⁴⁶ Kushtetuta, neni 108.9.

¹⁴⁷ Kushtetuta, neni 108.10.

¹⁴⁸ Kushtetuta, neni 110.2

¹⁴⁹ Ligji për Vetëqeverisje Lokale (03/L-040), neni 54.1.

Posti do të mbahet nga kandidati i cili vjen nga komunitetet jo-shumicë i cili pranon numrin më të madh të votave nga një listë e hapur e kandidatëve të Kuvendit Komunal.¹⁵⁰ Ai apo ajo do të kenë për detyrë promovimin e dialogut ndërmjet komuniteteve, dhe do të shërbejë si pikë fokusi për adresimin e brengave dhe interesave të komuniteteve jo-shumicë në punimet e Kuvendit të Komunës.¹⁵¹

Për më tepër, ai/ajo është i/e mandatuar për të shqyrtuar të gjitha ankesat nga pjesëtarët e komunitetit në lidhje me shkeljet e të drejtave të tyre nëpërmjet akteve apo vendimeve të Kuvendit Komunal. Zëvendëskryesuesi, në rrethana të veçanta, mund t'i paraqesë para Gjykatës Supreme aktet apo vendimet që konsiderohen se shkelin një të drejtë të caktuar të garantuar me Kushtetutë.¹⁵²

Komiteti Komunal për Komunitetet

Komiteti Komunal për Komunitetet është komitet i përhershëm i secilit Kuvend Komunal në Kosovë dhe përbëhet nga përfaqësues të komuniteteve që jetojnë në atë komunë dhe që janë anëtarë të Kuvendit Komunal. Secili komunitet që jeton në një komunë të caktuar duhet të përfaqësohet nga së paku një përfaqësues në kuadër të Komitetit për Komunitete, dhe përfaqësuesit e komuniteteve minoritare duhet të përbëjnë shumicën e anëtarëve të këtij komiteti.

Ky komitet është përgjegjës për shqyrtimin e pajtueshmërisë së autoriteteve komunale me legjislacionin dhe politikën, praktikën dhe aktivitetet e Komunave, me qëllim që të sigurojë që të drejtat dhe interesat e komuniteteve të respektohen plotësisht. Ky komitet gjithashtu i rekomandon masa Kuvendit Komunal për të siguruar zbatimin e direktivave qëllim të promovimit, ruajtjes dhe zhvillimit të identitetit etnik, kulturor, fetar dhe gjuhësor dhe për të siguruar mbrojtje adekuate të të drejtave të komuniteteve në komunë.¹⁵³

Zëvendëskryetari i Komunës për Komunitete (ZKKK)

Shih gjithashtu kaptinën 2.13 më poshtë.

¹⁵⁰ Kushtetuta, neni 54.2.

¹⁵¹ Kushtetuta, neni 55.1.

¹⁵² Kushtetuta, neni 62.

¹⁵³ Ligji për Vetëqeverisje Lokale (03/L-040), neni 53.

Në ato komuna ku së paku 10% të qytetarëve të komunës i përkasin komuniteteve që nuk përbëjnë shumicën në atë komunë, duhet të ekzistojë posti i Zëvendëskryetarit të Komunës për Komunitete (ZvKKK)¹⁵⁴, i cili zgjedhet për të njëjtin mandat sikurse Kryetari i Komunës.¹⁵⁵ Ai ose ajo ka për detyrë t'i ndihmojë kryetarit të Komunës dhe t'i jep atij apo asaj këshilla dhe udhëzime lidhur me çështje të ndërlydhura me komunitetet jo-shumicë.¹⁵⁶

Kryetari i Komunës duhet të konsultohet me ZKKK për çështjet që kanë të bëjnë me komunitetet jo-shumicë.¹⁵⁷

Emërimi dhe shkarkimi i ZKKK duhet të propozohet nga Kryetari i Komunës dhe të miratohet nga shumica e dyfishtë e deputetëve të Kuvendit Komunal (të pranishëm dhe që votojnë) dhe e deputetëve që i përkasin komuniteteve jo-shumicë (të pranishëm dhe që votojnë).¹⁵⁸

Në rastet kur ky post mbetet i lirë, Kryetari i Komunës duhet ta emërojë një Zëvendëskryetar të ri brenda 30 ditësh nga lirimi i postit.¹⁵⁹

Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim (ZKKK)

Secila Komunë në Kosovë ka një Zyrë Komunale për Komunitete dhe Kthim (ZKKK). Këto zyra janë të mandatuara për të “mbrojtur dhe promovuar të drejtat e komuniteteve, qasjen e barabartë të të gjitha komuniteteve në shërbimet publike dhe krijimin e kushteve për kthim të qëndrueshëm të refugjatëve, personave të zhvendosur brenda vendit dhe personave të riatdhesuar.”¹⁶⁰ Rrjedhimisht, ata mbajnë përgjegjësi të ndihmuar të kthyerit/riatdhesuarit dhe pjesëtarët e komuniteteve minoritare.

Njësia Komunale për të Drejtat e Njeriut (NjKDNj)

Secila Komunë është e obliguar me ligj që të themelojë një Njësi Komunale për të Drejtat e Njeriut (NjKDNj). Këto njësi janë të mandatuara për të monitoruar pajtueshmërinë me të drejtat e njeriut në nivelin komunal, veçanërisht në lidhje me diskriminimin, barazinë gjinore, fëmijët, personat me nevoja të veçanta, të drejtat e komuniteteve, përdorimin e gjuhëve dhe

¹⁵⁴ Kushtetuta, neni 61.1

¹⁵⁵ Kushtetuta, neni 61.2.

¹⁵⁶ Kushtetuta, neni 61.4.

¹⁵⁷ Kushtetuta, neni 58.1.

¹⁵⁸ Kushtetuta, neni 61.3.

¹⁵⁹ Kushtetuta, neni 61.5.

¹⁶⁰ Rregullorja e Qeverisë nr. 02/2010.

trafikimin me qenie njerëzore.¹⁶¹ Ata janë gjithashtu përgjegjëse për trajtimin e kërkesave të banorëve të komunës përkatëse në lidhje me të drejtat e njeriut.

Kompetencat e shtuara komunale

Disa Komuna me shumicë serbe gëzojnë kompetenca të shtuara në fushat të cilat vlerësohen si të rëndësishme së veçantë për komunitetet jo-shumicë. Përveç kompetencave të shtuara të diskutuara më sipër (kujdesit shëndetësor dytësor, arsimimit universitar, dhe kulturës) Komunitetet me shumicë serbe gjithashtu kanë të drejtë pjesëmarrjeje në përzgjedhjen e komandantëve të stacioneve lokale të policisë.¹⁶²

¹⁶¹ Udhëzimi Administrativ MAPL- Nr. 2008/02.

¹⁶² Ligji për Vetëqeverisje Lokale (03/L-040), neni 23.

III. ÇFARË TË BËNI NËSE TË DREJTAT TUAJA JANË SHKELUR

Nëse besoni që të drejtat tuaja individuale apo të komunitetit tuaj janë shkelur, natyrisht që është e mundur të dërgoni ankesën tuaj në gjykatë. Megjithatë, kjo gjë mund të jetë e shtrenjtë dhe të kërkojë kohë, ndërsa që ekzistojnë një numër opsionesh tjera që mund t'i provoni para kësaj.

2.12. Avokati i Popullit

Nëse besoni që të drejtat tuaja njerëzore apo të komunitetit tuaj janë shkelur apo keqtrajtuar nga institucionet apo autoritetet publike, ju inkurajojmë fuqimisht që të parashtroni ankesë tek zyra e Avokatit të Popullit.

Themeluar në qershor të vitit 2000, Avokati i Popullit është organ i pavarur me mandatin e shqyrtimit të shkeljeve të të drejtave të njeriut apo shpërdorimet e detyrës nga institucionet publike në Kosovë. Avokati i Popullit mund të hetojë ankesat e secilit në Kosovë.

Nëse dëshironi të parashtroni ankesën tek Ombudspersoni, ju mundeni:

- Të takoni Ombudspersonin ose një përfaqësues të tij personalisht, gjatë “Ditës së Hapur” (shihni më poshtë), ose
- Të plotësoni dhe të dërgoni një formular ankese tek një nga zyrat e Avokatit të Popullit. Gjatë Ditëve të Hapura, mund të takoheni me Ombudspersonin ose Zëvendës-Ombudspersonin personalisht, duke caktuar takim. Këto takime mund të caktohen duke kontaktuar njërën nga zyrat e Ombudspersonit (më shumë hollësi në fund të këtij kapitulli), ose duke shkruar tek adresa: ombudspersonkosovo@ombudspersonkosovo.org info@ombudspersonkosovo.org.
- Ditët e Hapura mbahen dy herë në muaj në Selinë e Prishtinës çdo dy javë, si dhe çdo muaj në Gjilan, Mitrovicë, Pejë, Graçanicë dhe Prizren. Ditët e Hapura gjithashtu mbahen në komuna të tjera, sipas nevojës.

Gjithashtu, mund të parashtroni ankesën nga distanca, duke plotësuar formularin e ankesës dhe duke e dorëzuar atë (me postë apo personalisht) tek

një nga zyrat e Ombudspersonit. Ky formular mund të kërkohet në këto zyra të Ombudspersonit, ose të shkarkohet në adresën:

<http://ombudspersonkosovo.org/repository/docs/ComplaintFormPDF.pdf>

Nëse gjuha juaj amtare nuk është njëra nga gjuhët zyrtare, ju keni të drejtën të paraqisni ankesën tuaj verbale apo të shkruar tek Institucioni i Ombudspersonit në gjuhën tuaj amtare. Ju gjithashtu keni të drejtë të merrni përgjigje në gjuhën tuaj amtare.

Informatat për kontakt

Zyra Qendrore në Prishtinë

Adresa: Rr. Enver Maloku 28 (Lagja Bregu i Diellit)
Tel: +381 (0) 38 501 401, 545 303
Fax: +381 (0) 38 545 302
Email: ombudspersonkosovo@ombudspersonkosovo.org

Zyra në Gjilan

Adresa: Rr. Adem Jashari, Ndërtesa II e Komunës
Tel: +381 (0)280 320 843
Orari i vizitave: E hënë dhe e enjte, 10.00 - 14.00

Zyra në Graçanicë

Tel: +381 (0) 38 65 118, +377 (0) 44 367 719, +381 (0) 64 37 11 137
Orari i vizitave: E hënë dhe e enjte, 10.00 - 14.00

Zyra në Prizren

Adresa: Rr. Remzi Ademi pn
Tel: +381 (0)29 222 138
Orari i vizitave: E hënë dhe e mërkure, 10.00 - 14.00

Zyra në Mitrovicë

Adresa: Sheshi Agim Hajrizi, pn, Ndërtesa Rajonale e Administratës Tatimore
Tel: +381 (0)28 530 138
Orari i vizitave: E hënë dhe e enjte, 10.00 - 14.00

Nën-zyra në Mitrovicë

Adresa: Rr. Filipa Višnjića 4, Aneksi i Trepçës,
Tel: + 377 (0)45 455 319, +381 (0)63 817 44 79
Orari i vizitave: E hënë dhe e enjte, 10.00 - 14.00

Zyra në Pejë

Adresa: Rr. Mbretëresha Teutë 59, Ndërtesa e Komunës, kati i 3^{të},
nr. 3

Tel: +381 (0)39 432 931

Orari i vizitave: E hënë dhe e enjte, 10.00 - 14.00

2.13. Ankesat kundër një vendimi komunal

Nëse dëshironi të ankoheni kundër një vendimi komunal, këtë mund ta bëni në mënyrë të drejtpërdrejtë, përmes mekanizmave si e drejta e peticionit apo iniciativa qytetare, ose në mënyrë të tërthortë, duke parashtruar ankesën tuaj tek Zëvendës Kryesuesi për Komunitete (ose te organet relevante komunale).

Mekanizmat e drejtpërdrejtë

E drejta e peticionit

Secili person apo organizatë që ka interes në komunë mund të dorëzojë peticion ndaj Kuvendit Komunal në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me përgjegjësitë dhe detyrat e asaj Komune.

Kuvendi Komunal duhet të shqyrtojë peticionin në pajtim me statutin dhe rregulloren e saj të punës.¹⁶³

E drejta për iniciativë qytetare

Qytetarët mund të marrin iniciativën për të propozuar rregullore, brenda kompetencave të komunës, për miratim nga Kuvendi apo me votë të qytetarëve në pajtim me ligjin në fuqi.¹⁶⁴

Propozuesit duhet të paraqesin propozim-rregulloren tek Kryesuesi i Kuvendit Komunal.¹⁶⁵

Për t'u kualifikuar për shqyrtim nga Kuvendi i Komunës, propozim-rregullorja duhet të jetë e nënshkruar nga 15% e votuesve të regjistruar.¹⁶⁶

¹⁶³ Ligji për Vetëqeverisje Lokale (03/L-040) (03/L-040), neni 69.

¹⁶⁴ Ligji për Vetëqeverisje Lokale (03/L-040), neni 70.1.

¹⁶⁵ Ligji për Vetëqeverisje Lokale (03/L-040), neni 70.2.

¹⁶⁶ Ligji për Vetëqeverisje Lokale (03/L-040), neni 70.3.

Kuvendi Komunal është i obliguar të shqyrtojë rregulloren e propozuar, si dhe të ndërmarrë veprime për të, brenda 60 ditësh nga pranimi i saj.¹⁶⁷

E drejta për referendum

Qytetarët e një komune mund të kërkojnë që një rregullore e miratuar nga Kuvendi i Komunës t'i nënshtrohet referendumit.¹⁶⁸

Kërkesa i duhet dorëzuar Kryesuesit të Kuvendit të Komunës brenda 30 ditësh nga miratimi i rregullores, si dhe duhet nënshkruar nga 10% e votuesve të regjistruar.¹⁶⁹

Kuvendi Komunal duhet të shqyrtojë dhe veprojë në bazë të kërkesës së vlefshme brenda 30 ditësh nga pranimi i saj.¹⁷⁰

Ankesat e qytetarëve

Ankesat e qytetarëve kundër një akti administrativ të organeve komunale duhen shqyrtuar në pajtim me Ligjin mbi Procedurën Administrative (Ligji nr 02/L-28).¹⁷¹ Teksti i plotë i këtij ligji është në dispozicion për shkarkim në adresën:

http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2005_02-L28_en.pdf.

Mekanizmat indirektë

Zëvendës-Kryesuesi i Kuvendit Komunal për Komunitete

Në komunat ku komunitetet jo-shumicë përbëjnë 10% të popullsisë së komunës, si dhe në një numër komunash të tjera, individët mund të mbështeten tek përfaqësuesi i tyre në Kuvendin Komunal, Zëvendës-Kryesuesi për Komunitete.¹⁷²

¹⁶⁷ Ligji për Vetëqeverisje Lokale (03/L-040), neni 70.4.

¹⁶⁸ Ligji për Vetëqeverisje Lokale (03/L-040), neni 71.1.

¹⁶⁹ Ligji për Vetëqeverisje Lokale (03/L-040), neni 71.2.

¹⁷⁰ Ligji për Vetëqeverisje Lokale (03/L-040), neni 71.3.

¹⁷¹ Ligji për Vetëqeverisje Lokale (03/L-040), neni 8.

¹⁷² Shih gjithashtu kaptinën 2.11 më sipër.

Nëse besoni që një akt apo vendim i Kuvendit Komunal ka shkelur të drejtat e komunitetit tuaj, mund të parashtroni ankesë tek Zëvendës-Kryesuesi për Komunitete, i cili pastaj është i obliguar ta shqyrtojë atë.¹⁷³ Zëvendës-Kryesuesi është përgjegjës për referimin e çështjes tek Kuvendi Komunal për trajtim.¹⁷⁴ Nëse Kuvendi zgjedh të mos rishqyrtojë aktin apo vendimin e tij, ose nëse Zëvendës-Kryesuesi konstaton që edhe pas rishqyrtimit, akti apo vendimi ende shkel një të drejtë të garantuar me Kushtetutë, ai/ajo mund ta parashtrorë lëndën në mënyrë të drejtpërdrejtë tek Gjykata Kushtetuese, e cila mund të vendosë nëse do ta pranojë lëndën për shqyrtim.¹⁷⁵

Mekanizmat e tjerë komunalë

Gjithashtu mund të ankoheni para Komitetit Komunal për Komunitete ose Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, që gjenden në secilën Komunë. Në komunat ku komunitetet jo-shumicë përbëjnë 10% të popullsisë së komunës, si dhe në një numër komunash të tjera, asgjë nuk mund t'ju ndalojë që të mos parashtroni ankesën tek zyra e Zëvendës-Kryetari për Komunitete. Megjithatë, aktualisht nuk ekziston ndonjë mekanizëm formal në fuqi për ta bërë këtë.

2.14. Mekanizmat për çështje të veçanta

Zyra e Komisionerit për Gjuhët

Zyra e Komisionerit për Gjuhët (ZKGJ) – e cila ka zëvendësuar ish-Komisionin e Gjuhëve – është themeluar në prill 2012 me qëllim të ruajtjes, promovimit dhe mbrojtjes së gjuhëve zyrtare (d.m.th. shqipes dhe serbishtes) dhe statusit të tyre të barabartë në Republikën e Kosovës dhe në komunat e saj, duke siguruar gjithashtu respektimin e të drejtave gjuhësore të komunitetit boshnjake, turk, goran, rom, ashkali dhe egjiptas, gjuhët e të cilëve nuk janë gjuhë zyrtare.

ZKGJ është përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit mbi Përdorimin e Gjuhëve.

Komisioni i Gjuhëve ka të drejtë të bëjë hetime ose:

- Në bazë të ankesës¹⁷⁶, ose

¹⁷³ Kushtetuta, neni 55.2.

¹⁷⁴ Kushtetuta, neni 55.3.

¹⁷⁵ Kushtetuta, neni 55.4.

¹⁷⁶ Ligji për Përdorimin e Gjuhëve (02/L-37), neni 32.3.

- Me iniciativën e vet¹⁷⁷.

Ju mund të dorëzoni ankesën tuaj tek Komisioni i Gjuhëve në bazën që, duke vepruar apo mos vepruar kur:

- Statusi i barabartë i gjuhëve zyrtare nuk është njohur apo nuk njihet.
- Çdo dispozitë e çdo ligji apo rregullore në lidhje me përdorimin e gjuhëve zyrtare apo gjuhëve të komuniteteve, gjuha amtare e të cilave nuk është gjuhë zyrtare, nuk është respektuar apo nuk respektohet.¹⁷⁸

Ju duhet ta bëni ankesën/kërkesën me shkrim, ta nënshkruani dhe ta dorëzoni tek Komisioni i Gjuhëve në Ndërtesën e Qeverisë,¹⁷⁹ ku ajo do të arkivohet. Ju duhet të merrni kopjen e kërkesës suaj të vulosur me vulën e qeverisë dhe datën. Nga ajo datë, Komisioni i Gjuhëve ka një periudhë prej 15 ditësh për t'iu dhënë një përgjigje zyrtare.

Në përmbyllje të hetimit, Komisioni mund të lëshojë rekomandime mbi:

- Korrigjimet e kërkuara, si dhe
- Mundësitë për përmirësim.¹⁸⁰

Në rastet kur rekomandimet e tij nuk janë zbatuar brenda një periudhe të arsyeshme, siç përcaktohet nga Komisioni, ai mund të lëshojë vërejtje me shkrim.

Nëse rekomandimet e Komisionit prapë nuk zbatohen brenda një periudhe të arsyeshme pasi të ketë lëshuar vërejtjen e tij me shkrim, kjo duhet të citohet në raportin e tij vjetor për Qeverinë dhe Kuvendin e Kosovës.¹⁸¹

Informatat për kontakt

Ndërtesa e Qeverisë, kati VI, nr. 605A
 Rr. Nëna Terezë pn, 10000 Prishtinë, Kosovë
 Tel: +381 38 200 14 448
 Email: info-zkgj-kpj@rks-gov.net
 Ueb: <http://www.commissioner-ks.org/>

¹⁷⁷ Ligji për Përdorimin e Gjuhëve (02/L-37), neni 32.4.

¹⁷⁸ Ligji për Përdorimin e Gjuhëve (02/L-37), neni 32.3.

¹⁷⁹ Shih adresën më poshtë.

¹⁸⁰ Ligji për Përdorimin e Gjuhëve (02/L-37), neni 32.6.

¹⁸¹ Ligji për Përdorimin e Gjuhëve (02/L-37), neni 32.8.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (KPMK)

Nëse mendoni që punëdhënësi publik ka shkelur parimin e mos-diskriminimit në bazat e përkatësisë së një pakice kombëtare, në procedurën e rekrutimit apo në ndonjë vendim që ka marrë, ju mund të parashtroni ankesën tek Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës (KPMK).¹⁸²

Para se ky Këshill të mund të shqyrtojë rastin tuaj, ju më së pari duhet të shteroni gjitha procedurat e brendshme të ankesës tek autoriteti punëdhënës në fjalë. Megjithatë, kjo procedurë fillestare mund të anashkalohet nëse Këshilli gjen prova të:

- frikës së arsyeshme për hakmarrje,
- dështimit të autoritetit punëdhënës që të zgjidhë ankesat e brendshme brenda tridhjetë (30) ditësh, ose
- ndonjë arsye tjetër të fuqishme.

Secila ankesë do të shqyrtohet nga një panel prej tre (3) anëtarësh të Këshillit. Gjatë paraqitjes së rastit para Këshillit, edhe ju edhe autoriteti punëdhënës në fjalë do të keni mundësinë që të paraqisni qëndrimet tuaja me shkrim, dhe këto dokumente do t'i vihen në dispozicion palës së kundërt.

Në rastet e kontesteve me fakte materiale, të dyja palët duhet të kenë mundësi të paraqiten në seancën dëgjimore para Këshillit, gjatë së cilës ato mund të paraqesin provat dhe dëshmitë gjatë marrjes në pyetje dhe hetimit.

Brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh nga përfundimi i procedurës për secilën ankesë të paraqitur, Këshilli duhet të lëshojë një vendim me shkrim që përshkruan vendimin e tij, duke arsyetuar bazën ligjore dhe faktike të atij vendimi.

Informatat për kontakt

Rr. Nënë Tereza (Ndërtesa e Gërmisë), Zyra A-301, 10 000, Prishtinë

Tel: +381 (0) 38 212 040, ext: 10 949, +377 44 366 973

Mail: miran.zeneli@ks-gov.net

Ueb: <http://kpmshc.rks-gov.net/>

182 Ligji për këshillin e Pavaruar Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (2010/03-L-192).

Në rastet kur Këshilli vendos që autoriteti punëdhënës ka kryer shkelje, ai duhet të urdhërojë një mjet të përshtatshëm juridik me shkrim drejtuar zyrtarit të lartë menaxhues ose zyrtarit kryesor ekzekutiv/kryshefit ekzekutiv të autoritetit përkatës punëmarrës Ai/ajo pastaj do të jetë përgjegjës/e për të siguruar zbatimin e urdhrit të organit të punësimit brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga pranimi i vendimit. Megjithatë, në rastin kur organi punëdhënës nuk e zbaton atë, Këshilli do t'ia raportojë këtë Kryeministrit dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të personir përgjegjës për ekzekutim.

Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM)

Nëse mendoni që një medium ka shkelur obligimet e tij ndaj komuniteteve, ju mund të parashtroni ankesë tek Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM).

Megjithatë, duhet ta dini që shumë ankesa mund të trajtohen pa përfshirë KPM-në dhe ia vlen të mundoheni të kontaktoni mediumin në fjalë më së pari.

Informatat për kontakt

Zyra e Komisionit të Pavarur për Media

Rr. Gazmend Zajmi 1, 10 000 Prishtinë

Tel: +381 (0)38 245 031

Faks: +381 (0)38 245 034

Email: info@kpm-ks.org

Ueb: <http://kpm-ks.org/>

IV. KORNIZA LEGJISLATIVE

Në vijim jepet lista e ligjeve më të rëndësishme në Kosovë që janë relevante për çështjet e komuniteteve:

- Kushtetuta e Republikës së Kosovës
<http://www.kuvendikosoves.org/?cid=1,100,48>
- Ligji për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Kosovë (03/L-047)
<http://gazetazyrtare.rks-qov.net/Documents/shqip-3.pdf>
- Ligji i plotësuar-ndryshuar për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Kosovë (04/L-020)
[http://gazetazyrtare.rks-qov.net/Documents/Ligji%20per%20P.N.%20Mbrojtjen%20dhe%20promovimin%20e%20te%20drejtave%20\(shqip\).pdf](http://gazetazyrtare.rks-qov.net/Documents/Ligji%20per%20P.N.%20Mbrojtjen%20dhe%20promovimin%20e%20te%20drejtave%20(shqip).pdf)
- Ligji kundër Diskriminimit (2004/3)
http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2004_3_al.pdf
- Ligji për Vetëqeverisje Lokale (2008/03-L040)
<http://www.kuvendikosoves.org/?cid=1,191,249>
- Ligji për Përdorimin e Gjuhëve (2006/02-L37)
<http://www.kuvendikosoves.org/?cid=1,191,204>
- Ligji për Qendrën Historike të Prizrenit 2011/04-L-066)
<http://www.kuvendikosoves.org/?cid=1,191,940>
- Ligji mbi Zonat e Veçanta të Mbrojtura (2008/03-L039)
<http://www.kuvendikosoves.org/?cid=1,191,248>
- Ligji për Radio-Televizionin e Kosovës (2011/04-L-046)
<http://www.kuvendikosoves.org/?cid=1,191,860>
- Ligji për Komisionin e Pavarur të Mediave (04/L-044)
<http://www.assembly-kosova.org/?cid=1,191,848>
- Ligji për Arsimin në Komunitatet e Republikës së Kosovës (03/L-068)
<http://www.assembly-kosova.org/?cid=1,191,265>
- Ligji për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës (2011/04-L-032)
<http://www.assembly-kosova.org/?cid=1,191,666>

ECMI Kosovo

Rr. Nëna Terezë nr. 41, Apt. 29
10000 Prishtinë, Kosovë
Tel. +381 (0) 38 224 473

Email: info@ecmikosovo.org

Ueb: www.ecmikosovo.org

Rr. Čika Jovina Nr. 3, 1st Fl
38220 Mitrovicë Veriore, Kosovë
Tel. +381 (0) 64 00 55 488

